



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

INDEKSI I MBROJTJES SË FËMIJËS 2.0

Kosovë 2017

Vlerësimi i përpjekjeve të qeverisë
për mbrojtjen e vajzave dhe djemve

www.childprotectionindex.org



Zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për
Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF

ChildPact



Organizatave anëtare të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë janë:

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve Kosovë është koalicioni i përbërë nga 27 OJQ lokale dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, me mision të përbashkët avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Koalicioni punon në promovimin e mbrojtjes, respektimit, mirëqenies dhe

avancimit të të drejtave të fëmijëve. Së bashku do të avokojmë dhe llobojmë tek institucionet me influencë për të promovuar dhe zhvilluar të drejtat e fëmijëve në pajtim me KDF. www.komfkosova.org

Asociacioni për Trajtime Sociale Hulumtime dhe Avokim – ASTRA · Aksioni për Nëna dhe Fëmijë · Balkan Sunflowers Kosova · Childproof – CIPOF · Education Comes First · Iniciativa 6 · Kosovo Education for Sustainable Development · HANDIKOS · Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës QKRMT · Organizata Rinore Akti · Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror · One To One Kosova – Qendra e Këshillimit për Familje · One to One Children's Fund · OPFAKKOS

· Programi për të Drejtat Civile – CRP/K · PLAY International · Qendra për Edukim e Kosovës – KEC · Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore – MVPT · Qendra për Studime të Avancuara – FIT · Save the Children · SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë · Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF · Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK · Terre des hommes · The Ideas Partnership · VoRAE dhe WorldVision.

ChildPact

ChildPact është koalicioni rajonal i 650 organizatave të shoqërisë civile që avokon për një reformë më të madhe të mbrojtjes së fëmijëve në nën rajonet e Evropës Juglindore dhe Kaukazit Jugor. Themeluar në vitin 2011, ChildPact është një koalicion i koalicioneve: anëtarët e tij janë koalicione nacionale të organizatave të shoqërisë civile të fokusuar tek fëmijët që i përkasin 10 shteteve brenda zonave të zgjerimit dhe atyre në fqinjësi me Bashkimin Evropian. www.childpact.org

World Vision International

World Vision International është organizatë Kristiane për ndihmë, zhvillim dhe avokim e dedikuar në punën me fëmijët, familjet dhe komunitetet për të tejkaluar varfërinë dhe padrejtësinë. Zyra e World Vision International për Lindjen e Mesme dhe Evropën Lindore është partner zyrtar për Indeksin e Mbrojtjes së Fëmijëve. www.wvi.org/meero

Dhjetor 2017

Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës i serisë 2.0 zbatohet në Kosovë.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në çfarëdo forme pa citim paraprak që identifikon emrin e burimit, partnerëve dhe vitin e publikimit.

Publikuar nga KOMF, në partneritet me ChildPact dhe World Vision International. Për informata të tjera rreth këtij publikimi ose për kopje shtesë të këtij publikimi ju lutemi dërgoni email në: info@komfkosova.org, contact@childpact.org

Ky publikim është mundësuar në kuadër të projektit "Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë", projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, i udhëhequr nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijës KOMF.

Përmbajtja dhe pikëpamjet e raportit "Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijës 2.0" janë përgjegjësi e vetme e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

Shkurtesat

1 Hyrje

Mesazh i Drejtorit Ekzekutiv të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF
Mesazh i Drejtorit të Zyrës për Avokim dhe Politika të World Vision International për Lindjen e Mesme dhe Evropën Lindore

4 Metodologjia e Indeksit

9 Analizë dhe rekomandime mbi politikat

Cënueshmëria e fëmijëve
Qeverisja
Ndalimi dhe parandalimi:
- Të gjitha format e dhunës
- Shfrytëzimi ekonomik
- Shfrytëzimi seksual
- Rrëmbimi, shitja dhe trafikimi
Kujdesi dhe mbrojtja
- Aftësia e kufizuar
- Parandalimi i ndarjes – Ndhinë familjeve për të qëndruar së bashku
- Inicimi i ndarjes – Mbrojtja e fëmijëve të sigurtë
- Pas ndarjes – Kujdesi për fëmijët e ndarë nga familjet e tyre
- Adoptimi
- Fëmijët që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë
- Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë
- Fëmijët refugjatë, fëmijët që kërkojnë azil dhe fëmijët e përfshirë në konflikte të armatosura
- Tortura dhe çdo trajtim ose dënim tjetër mizor, çnjerezor ose poshtëruës ndaj fëmijëve
- Administrimi i drejtësisë për të mitur

44 Përfundimet mbi politikat

47 Mirënjohje

Donatori
Këshilltari dhe Menaxheri për mbledhjen e të dhënave
Autorët
Vizualizimi dhe Dizajni i të dhënave
Fotografia

51 Shtojcë: Metodologjia e detajuar e Indeksit

Shkurtesat

CEE/CIS	Evropa Qëndrore dhe Lindore/Komonuelthi i Shteteve të Pavarura
CPI	Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MD	Ministria e Drejtësisë
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
QPS	Qendra për Punë Sociale
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
WV	World Vision
UNCRC	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Hyrje

Mjeti monitorues i unifikuar i shoqërisë civile për Kosovë dhe mbrojtja e fëmijëve

Fëmijët në Kosovë përbëjnë 30% të popullsisë së përgjithshme. Jetët e fëmijëve në Kosovë preken çdo ditë nga politikat e Qeverisë, Kuvendit, Komunave, shoqërisë civile dhe veprimet e tyre.

Kosova si vend që synon integrimin në Bashkimin Evropian, në bazë të Kushtetutës së saj, ka detyrime të qarta ligjore për të promovuar të drejtat e fëmijëve dhe për të siguruar mbrojtjen e secilit fëmijë brenda juridiksionit të saj.

Në këtë drejtim, Kosova ka ndërmarrë shumë hapa pozitiv në krijimin e politikave dhe kornizës ligjore për mbrojtjen e fëmijëve. Tashmë Kosova duhet të zbatojë legjislacionin dhe të sigurojë burimet adekuate përmes së cilave do të fuqizojë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Të dhënat e fundit tregojnë një shkallë prej 20.7% të varfërisë së fëmijëve. 10.7% e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në punë, ndërsa 6.8% e fëmijëve punojnë në kushte të rrezikshme. 61.4% e fëmijëve deri në moshën 14 vjeç kanë përjetuar dhunë psikologjike dhe fizike. Vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale. Raportet nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare flasin për përfshirjen e fëmijëve në sjelljet që janë në kundërshtim me ligjin, përfshirë edhe dhunën.

Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës vë në pah se Kosova ka një boshllëk të madh mes legjislacionit të miratuar dhe zbatimit të tij. Përmes Indeksit, ne synojmë të identifikojmë boshllëqet ndërmjet politikave dhe zbatimit duke dokumentuar faktet e disponueshme nga terreni dhe duke ofruar një bazë të përgjithshme, rigorozë por të qasshme të dëshmive që do të hapte debatet mbi politikat dhe zbatimin e tyre. Kosova duhet të bëjë investime financiare për të ndërtuar kapacitetet që do të mbyllnin hendekun midis legjislacionit dhe zbatimit të tij.

Indeksi ofron mundësi që të gjithë aktorët të unifikojnë dhe përforcojnë të kuptuarit e situatës së mbrojtjes së fëmijëve në shtetin tonë dhe në të gjithë rajonin. Presim që qeveria, donatorët dhe pjesëtarët e shoqërisë civile të mund të përdorin rekomandimet nga Indeksi në rritjen e ofrimit të shërbimeve, kapacitetit institucional, koordinimit dhe llogaridhënies, për mbylljen e hendekut midis legjislacionit dhe zbatimit të tij.



DONJETA KELMENDI
DREJTORESHË EKZEKUTIVE

Qëllimi i 16 i Zhvillimit të Qëndrueshëm thekson se zhdukja e varfërisë dhe promovimi i paqes kërkon institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ky qëllim ja atribuon këtë logjikë objektivit 16.2, "jepini fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës kundër fëmijëve", sepse ne si qytetarë dhe mbrojtës të tyre duhet të mbështetemi në qeveritë tona që ato ta japin kontributin e tyre për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve, për ti mbrojtur ata kur janë viktimë të dhunës dhe për t'ju përgjigjur nevojave të tyre për shërim dhe trajtim.

Qeveritë duhet ta ndjekin këtë praktikë thelbësore përmes prezencës së tyre institucionale në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Për ta përbushur objektivin 16.2, nuk është e nevojshme që qeveritë të bëjnë diçka të jashtëzakonshme, por në fakt është puna e zakonshme e qeverisjes e cila përfshin veprime politikash, vendosje të rregullave, alokime buxhetore, zbatim të rregullave dhe struktura të qarta të llogaridhënies për të verifikuar rezultatet e arritura.

Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0 është një mjet që shërben për të monitoruar përbushjen e këtyre detyrave shumë të "zakonshme". Rekomandimet që pasojnë kanë të bëjnë me këto detyra; për shembull, standarde më të larta për të pasur shërbime të sigurta dhe të qëndrueshme për fëmijët, më shumë fonde për të përbushur përkushtimet ndaj fëmijëve, një koordinim më i mirë për të trajtuar kompleksitetin e çështjeve me të cilat përballen fëmijët dhe njohuritë e reja lidhur me strukturat e llogaridhënies që marrin parasysh zërat e fëmijëve. Këto janë pikërisht ato rekomandime që mund t'i ndihmojnë qeveritë në përbushjen të detyrës së tyre me qëllim të përbushjes së objektivit 16.2 dhe SZHQ 16.

Ne shpresojmë që përmes Indeksit të Mbrojtjes së Fëmijëve, shoqëria civile do të mund të ndihmojë, inkurajojë dhe të avokojë tek qeveria për t'i përbushur këto detyra të zakonshme të cilat mund të çojnë në rezultate të jashtëzakonshme: ku vajzat dhe djemtë e Kosovës mbrohen nga dhuna dhe gëzojnë kujdes të duhur duke parandaluar kështu çdo paraqitje të dhunës në jetën e më të cënueshmeve.

Ngrohtësisht,

Jocelyn Penner Hall



JOCELYN PENNER HALL

DREJTOR PËR AVOKIM DHE POLITIKA

.....

WORLD VISION INTERNATIONAL



Metodologjia e Indeksit

Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijëve është dizajnuar në mënyrë që të inkurajojë bashkëpunimin rajonal, të stimulojë zbatimin e fuqishëm të KDF dhe të shërbejë si mjet i shoqërisë civile, qeverive dhe donatorëve për analiza të politikave. Përmes Indeksit, ne synojmë të identifikojmë boshllëqet ndërmjet politikave dhe zbatimit / implementimit, duke dokumentuar faktet e disponueshme nga terreni dhe duke ofruar një bazë të përgjithshme rigoroze, por të qasshme të dëshmive që do të hapte debatet mbi politikat. Indeksi përbëhet nga 987 indikatorë kyç të cilët së bashku masin politikat dhe veprimet e shtetit për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për vajzat dhe djemtë nën juridiksionin e tyre. Korniza e indikatorëve të Indeksit mbështetet fuqimisht në Doracakun e Zbatimit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, publikuar nga UNICEF. Doracaku ofron një seri të pyetjeve me përgjigje po/jo dhe pjesërisht për të krijuar të kuptuarit e rëndësisë së secilit nen të KDF. Indeksi përdor këto lista kontrolli si indikatorë kyç për matje të performancës së shtetit përmes pesë fushave/dimensioneve: politikat dhe ligji, shërbimet, kapacitetet, koordinimi dhe llogaridhënia.

Publikimi që po lexoni tani është versioni i dytë i Indeksit. Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 1.0 është nxjerrë në nëntor 2016 në Kosovë dhe ka ofruar dëshmi, rezultate dhe gjetje mbi gjendjen e Kosovës deri në fund të vitit 2013¹.

Meqë qëllimi i Indeksit si mjet monitorues është ndërtimi i një procesi monitorimi afatgjatë dhe të vazhdueshëm në pronësi të organizatave të shoqërisë civile, Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0 do të ofrojë dëshmi dhe gjetje të përditësuara lidhur me situatën në Kosovë, deri në fund të vitit 2016.

Jemi shumë entuziastë për dimensionin e tij krahasues dhe fuqimisht inkurajojmë përsëritjen e kësaj praktike të mirë dhe unifikimin e veprimeve të qeverisë në lidhje me çështjet e përbashkëta.

Vlerësimi i Indeksit të 2017 bazohet në të dhënat e disponueshme deri në dhjetor 2016. Ju lutemi shihni shtojcën e kësaj përmbledhjeje për informacione të mëtejshme mbi kornizën e Indeksit, grumbullimin e të dhënave dhe vlerësimin e tyre.

Për të lexuar Indeksit, rezultati me një pikë është rezultati maksimal; sa më i ulët të jetë rezultati, aq më i dobët është veprimi i ndërmarrë; sa më i lartë të jetë rezultati, aq më i fuqishëm është veprimi i ndërmarrë për fëmijët.

Dimensionet e veprimit të qeverisë

Indeksi vlerëson pesë dimensione të veprimit të qeverisë për secilin prej neneve të KDF që i referohen mbrojtjes së fëmijës. Këto pesë dimensione janë: politikat dhe ligjet, shërbimet, kapaciteti, koordinimi dhe llogaridhënia.

Politikat dhe ligjet

Dimensioni i politikave dhe ligjeve mat përpjekjet e shtetit për të krijuar politika, ligje dhe rregullore të cilat mbrojnë fëmijët në situata dhune dhe cënueshmërie.

Shërbimet

Dimensioni i shërbimeve mat përpjekjet e shtetit për të ofruar shërbime për fëmijët në rrezik apo viktime të shfrytëzimit ose ata në nevojë për kujdes të veçantë.

Kapaciteti

Dimensioni i kapacitetit mat përpjekjet e shtetit për të siguruar burimet, stafin, infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme për të zbatuar si duhet politikat dhe shërbimet për fëmijët.

Koordinimi


Dimensioni i koordinimit mat përpjekjet e shtetit për të koordinuar në mënyrë efektive ministritë, agjensitë dhe nivelet e Qeverisë.

Llogaridhënia

Dimensioni i llogaridhënies mat përpjekjet e shtetit për të krijuar llogaridhënie për veprimet e sektorit publik dhe për të formalizuar përgjegjësitë në mënyrë që aktorët e sektorit publik t'i dinë rolet dhe kufijtë e përgjegjësive të tyre.

Indikatorët e Indeksit

Korniza e Indeksit përbëhet nga gjithsej 987 indikatorë që janë kategorizuar në seksionet vijuese.



Ekipi i Indeksit

Ekipi nacional ka hulumtuar dhe grumbulluar të dhëna për t'ju përgjigjur secilës pyetje të indikatorit të Indeksit. Menaxheri rajonal për të dhënat ka analizuar rezultatet në nivel vendi dhe ka shfaqur këto rezultate në mënyrë vizuale.

Ekipi rajonal

Menaxher i mbledhjes
së të dhënave

Këshilltar
ndërkombëtar

Ekipi nacional 14

10


Ekspertë të
mbrojtjes së
fëmijëve

2

Ekspertë
ligjor

2

Ekspertë
financiar



Analizë dhe rekomadime mbi politikat

Cënueshmëria e fëmijëve Qeverisja

Kosova ka arritur një rezultat prej 0,520 nga totali 1.0 i mundshëm duke ruajtur kështu rezultatet e një qeverisjeje të ngjashme të raportuar në Indeksin e Mbrojtjes së Fëmijës 1.0 të publikuar vitin e kaluar².

Qeverisja i referohet procesit të bërjes dhe avancimit të ligjeve, ndërsa Indeksi vlerëson nëse Qeveria i ka përcjellë aspektet e qeverisjes së mirë për zbatimin e KDF. Qeverisja e mirë i mbështet të drejtat e qytetarëve, ofron qasje transparente në informata, mbështetet në vendimmarrje dhe sundim konsistent të ligjit si dhe vazhdon të mbështesë të mirën publike³.

Brenda legjislacionit të saj, Kosova ka përshtatur qasjen ndaj të drejtave të fëmijëve në gjuhën dhe frymën e KDF. Fokus i fuqishëm në interesin më të mirë të fëmijës i jepet pikëpamjeve të vetë fëmijëve në qendër të mbrojtjes së tyre.

Rezultati megjithatë pasqyron konsolidimin e kufizuar të ligjeve të Kosovës që mbrojnë fëmijët dhe dobësitë e organeve formale që monitorojnë, inspektojnë dhe mbajnë përgjegjësi të gjithë aktorët e ngarkuar me mbrojtjen e fëmijëve. Projektligji i Kosovës për Mbrojtjen e Fëmijëve, nëse miratohet, do të përmirësojë rezultatit e qeverisjes së saj; ai do të konsolidojë një seri të më shumë se 14 ligjeve që rregullojnë aktorët dhe vendosin politika për fëmijët.

Tipar kyç i qeverisjes së mirë është edhe vendimmarrja e koordinuar. Kosova ka krijuar një numër të organeve koordinuese për të frymëzuar shkëmbimin e informacionit dhe vendimmarrjen e bazuar në fakte nga aktorë të ndryshëm të mbrojtjes së fëmijëve. Aktualisht, diskutimet mbi politikën ndërmjet ministrive mbështeten nga një trup koordinues i posaçëm për të drejtat e fëmijëve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mos Diskriminim.

Gjithashtu, brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme ekziston një trup i veçantë i cili merret me çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore (Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz).

Kosova ka krijuar një trup të veçantë koordinues që merret me çështjen e punëve të rënda të fëmijëve (Komiteti i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve) brenda Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. [Hapi i ardhshëm duhet të përfshijë fuqizimin e trupave koordinues dhe monitorues ndërmjet ministrive për të zgjeruar përpjekjet e adresimit të mbrojtjes së fëmijës meqë, trupa të tillë duhet të unifikojnë detyrat dhe rezultatet duke përdorur ekspertizën e të gjitha ministrive relevante.](#)

Gjithashtu, [rekomandohen diskutime të rregullta dhe të fuqishme ndërmjet autoriteteve të financave dhe mbrojtjes sociale gjë e cila ende nuk është zbatuar.](#) Pa një mekanizëm të caktuar për alokimin dhe rishikimin vjetor të buxhetit dhe shpenzimeve, zyrtarët mund të jenë të kufizuar në mundësitë e tyre për të krijuar buxhete të sakta dhe të përshtatshme. [Buxheti i përgjithshëm i shtetit duhet](#)

të parashikojë ndarjen e një Granti Specifik për Shërbime Sociale për fëmijët e cënueshëm. Ky grant do t'i fuqizonte komunitetet dhe institucionet vendore në ofrimin e shërbimeve cilësore për këta fëmijë. Analizat buxhetore për të gjitha çështjet e mbrojtjes së fëmijëve duhet të shqyrtojnë proporcionin e buxheteve të përgjithshme të dedikuara për fëmijët dhe të identifikojnë çfarëdo parregullsie ndërmjet komunave të Kosovës, zonave rurale/urbane dhe grupeve të veçanta të fëmijëve. Është e rëndësishme që zyrtarët të jenë në gjendje të verifikojnë se fonde të mjaftueshme arrijnë te grupet më të cënueshme të fëmijëve.

Gjithashtu, me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies, koordinimi duhet të përfshijë konsultime të rregullta me ekspertët për mbrojtjen e fëmijëve dhe me vetë fëmijët. Së fundi, rezultati i Indeksit të Kosovës mbi qeverisjen zbulon nevojën për përpjekje të mëtejshme të monitorimit. Kosova ka mandatuar zyrën e pavarur të avokatit të popullit për të drejtat e njeriut e cila promovon edhe të drejtat e fëmijëve.

Për të konfirmuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve, duhet të caktohet një përfaqësues dhe të krijohet një departament që do të dedikohet të drejtave të fëmijëve në kuadër të Zyrës së Avokatit të Popullit. Duhet të kihet parasysh rritja e burimeve njerëzore dhe financiare për Zyrën e Avokatit të Popullit në mënyrë që të zgjerohen aktivitetet e tij në këtë fushë. Përndryshe, mund të jetë e vështirë të parashtrohen ankesa kundër organeve të ndryshme qeveritare kur ka dyshime për shkelje të të drejtave të fëmijëve.

Rekomandohet krijimi i mekanizmave të jashtëm dhe të pavarur të inspektimit për të shqyrtuar cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe për të administruar licencimin. Inspektimi duhet të vlerësojë si shërbimet private ashtu edhe ato të sektorit publik (QPS).

Gjithashtu, Kuvendi duhet të krijojë një organ për mbrojtjen e fëmijëve me mandat të definuar qartë për të monitoruar mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë dhe për të reaguar në çështje specifike, kur ka të tilla. Komisioni parlamentar duhet që rregullisht të takohet për të mbajtur diskutime në përputhje me axhendën legjislative⁴.

Gjithashtu, Qeveria duhet të sigurojë një vend për fëmijët në çdo proces vendimmarrës ose monitorues. Pa pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve, përfituesit e vetë sistemit do të mbesin jashtë diskutimit.

Mos diskriminimi

Neni 2 i KDF kërkon nga Shtetet Palë të respektojnë të drejtat e përmedura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije që gjendet nën juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës, e prindërve të tij ose e përfaqësuesve të tij ligjorë. Ai kërkon nga Shtetet Palë që të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij/saj, të përfaqësuesve të tij/saj ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij.

Kosova ka shënuar rezultat prej 0,583 nga një maksimum i mundshëm prej 1.0 në përpjekjet e saj për të siguruar që të drejtat e fëmijëve ofrohen për të gjithë fëmijët pa diskriminim. [Për të përmirësuar më tej rezultatin e saj, Kosova duhet të ndërmarrë veprime drejt zbatimit të marrëveshjeve globale dhe sugjerimeve për politikën.](#) Pa zbatimin e këtyre hapave, Kosova nuk mund të sigurojë se të drejtat e vajzave, fëmijëve nga grupet minoritare, përfshirë komunitetin Rom dhe fëmijët me aftësi të kufizuara po respektohen.

Gjithashtu, Kosova është e kufizuar nga mungesa e të dhënave të ndara, për të monitoruar në mënyrë efektive aktet dhe lëshimet e mundshme që çojnë në diskriminim të grupeve të ndryshme të cënueshme. Ndërkohë që për shembull, fëmijët me aftësi të kufizuara identifikohen dhe njihen si një grup veçanërisht i cënueshëm, mungesa aktuale e të dhënave për këto grupe të fëmijëve nuk lejon planifikim adekuat strategjik dhe zgjidhje të suksesshme zhvillimore. [Prandaj, për të kuptuar më mirë situatën, është e rëndësishme që Kosova të fillojë mbledhjen dhe raportimin e të dhënave që janë të ndara sipas moshës dhe gjinisë.](#)

Regjistrimi i lindjeve

Është e drejtë e çdo fëmije të ketë një emër dhe shtetësi, si në KDF dhe në traktate të tjera ndërkombëtare. Regjistrimi i fëmijëve pas lindjes siguron njohjen e tij përpara ligjit, mbron të drejtat e fëmijës dhe siguron që çdo shkelje e këtyre të drejtave mund të adresohet. Regjistrimi i përgjithshëm i lindjeve kontribuon edhe në sistemin e statistikave vitale të Kosovës, që është thelbësore për planifikim të shëndoshë ekonomik dhe social. Prandaj, regjistrimi i lindjeve është jo vetëm një e drejtë themelore e njeriut por edhe një e drejtë kyçe për të siguruar përmbushjen e të drejtave të tjera dhe për të lejuar vendime më të fuqishme politike.

Shkalla e regjistrimit të lindjeve në Kosovë prej 89.1 përqind, është e ulët në krahasim me normat mesatare të ofruara nga vendet në rajonin e EQL / CIS (98%)⁵. Sipas të dhënave të UNICEF, Kosova ka shkallën më të ulët të regjistrimit të lindjeve në rajon⁶.

Megjithëse fëmijët e paregjistruar në Kosovë nuk përjashtohen nga arsimi fillor dhe kujdesi shëndetësor, shumë familje me fëmijë të paregjistruar nuk mund të marrin asistencë sociale. Fëmija i një parashtruesi të kërkesës për ndihmë sociale pa regjistrim të lindjes ose pa dokumente identifikimi, me rastin e llogaritjes së ndihmës sociale, nuk llogaritet si anëtar i ekonomisë familjare. Po ashtu, regjistrimi i lindjeve është thelbësor në përpjekjet për mbrojtjen e tyre ku përfshihet: parandalimi i punës së fëmijëve përmes zbatimit të ligjit për moshën minimale të punësimit; sigurimi i asaj që fëmijët në konflikt me ligjin të mos trajtohen (ligjërishit dhe praktikisht) si të rritur; luftimi i martesave të fëmijëve; zvogëlimi i trafikimit, riatdhesimi dhe ribashkimi i fëmijëve me anëtarët e familjes.


Rezultati i indeksit të Kosovës (0,833) në nenin 7 reflekton faktin se vendi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përafrimit të plotë të politikave të regjistrimit të lindjeve me kërkesat e KDF. [Janë të nevojshëm hapa të mëtejme për të rritur qasjen në regjistrimin e lindjeve ashtu që autoritetet shtetërore të kenë një qasje më proaktive drejt identifikimit të fëmijëve të paregjistruar dhe për të siguruar regjistrimin e tyre duke përfshirë \(nëse është e nevojshme\) edhe angazhimin e njësisve komunale mobile për regjistrim.](#)

Rezultatet e parandalimit të dhunës dhe shfrytëzimit

Të gjitha format e dhunës

“Të gjitha format e dhunës” të përfshira në nenin 19 të KDF i referohen dhunës fizike apo mendore, dëmtimit ose abuzimit, neglizhimit apo trajtimit mospërfillës, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, përfshirë edhe abuzimin seksual.

Veprimet e Kosovës për të parandaluar gjithë format e dhunës ndaj fëmijëve janë më të dukshme në ligjet dhe politikat e saj (0,823) dhe protokolet e koordinimit me 0,757. Përderisa kapaciteti i Kosovës është i kufizuar (0,400), puna e saj për të ndërtuar shërbime të përshtatshme që parandalojnë, ndërhyjnë dhe mbështesin fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës reflektohen në një rezultat prej 0,611. Llogaridhënia ndaj përfituesve, familjeve dhe aktorëve të tjerë është e ulët me një rezultat prej 0,474. Rezultatet tregojnë për ekzistimin e një mospërputhjeje të gjerë ndërmjet shërbimeve të caktuara të Kosovës dhe kapacitetit të saj për t'i zbatuar ato në mënyrë efektive. Një boshllëk tjetër i madh është bërë i dukshëm në mes të ligjeve dhe politikave të Kosovës dhe zbatimit të këtyre zotimeve me një rezultat prej 0,336.



Megjithëse rezultati për ligjet dhe politikat e Kosovës në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna është i lartë, hapat e ardhshëm duhet të përfshijnë veprime në krijimin e një sistemi të fuqishëm rregullator për mbështetjen e zbatimit të këtyre ligjeve. Aktualisht, korniza rregullatore nuk ofron standarde financiare për të gjitha shërbimet që ofrohen apo sponsorizohen nga shteti që lidhen me parandalimin e dhunës dhe shfrytëzimit. **Prandaj, rekomandohet që Kosova të ofrojë standarde financiare për të gjitha shërbimet që ofrohen apo sponsorizohen nga shteti.** Korniza ligjore ose rregullatore nuk kërkon licencimin e detyrueshëm të shërbimeve të ofruara nga entitetet qeveritare por, kërkon licencimin e detyrueshëm të shërbimeve të ofruara nga OJQ-të/entitetet private. **Rekomandohet që Kosova, për të rritur cilësinë e të gjitha shërbimeve, të kërkojë edhe licencimin e detyrueshëm të shërbimeve të ofruara nga organizatat qeveritare në bazë të kërkesave të standardeve minimale të cilësisë.**

Sa i përket parandalimit, janë bërë përpjekje për të parandaluar veprimet e përcaktuara si "dhunë" ose që çojnë deri në dhunë nga organet institucionale (shkollat, drejtësia, mjediset familjare). Në institucionet arsimore, dhuna është e ndaluar dhe Ligji për Familjen i Kosovës ndalon aktet e dhunës në mjediset familjare dhe mundëson kufizimin ose ndalimin e të drejtave prindërore në këto raste⁷. **Për këtë arsye, rekomandohet promovimi më tej i raportimit mes bashkëmohatarëve dhe vetë raportimi, përmes veprimtarive që rrisin ndërgjegjësimin tek fëmijët dhe të rinjtë.**

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës vërtetojnë rezultatin e lartëpërmendur, përmes të dhënave që tregojnë një përqindje shumë të lartë të dhunës ndaj fëmijëve në Kosovë ku 61.4 përqind e fëmijëve në Kosovë kanë konfirmuar përvojat e dhunës fizike/psikologjike brenda mjedisit familjar⁸.

Megjithatë, shërbimet shtetërore identifikuan dhe arritën në total tek vetëm 41 fëmijë, në mbarë vendin, si viktime të dhunës dhe përfitues të shërbimeve familjare dhe sociale. Këto shifra tregojnë për një referim dhe raportim të dobët të rasteve dhe për kapacitete të kufizuara për të identifikuar fëmijët që kanë nevojë për ndihmë.

Identifikimi dhe raportimi i fëmijëve në situata të dhunës është hapi i parë për mbrojtjen e fëmijëve. Kosova i obligon të gjithë zyrtarët shtetërorë dhe profesionistët që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe drejtësisë, të raportojnë dyshimet për dhunë në Qendrën për Punë Sociale respektive ose tek autoritetet policore të Kosovës. Përkundër kësaj kërkese, referimet nga këto institucione mbeten në shkallë të ulët sidomos në rastet e dhunës në shkolla. [Rekomandohet që Kosova të fillojë me trajnime dhe fushata vetëdijësimi për t'i përkujtuar zyrtarëve shtetëror dhe profesionistëve për detyrën e tyre për të raportuar rastet e dhunës së dyshuar ndaj fëmijëve.](#)

Pasi të jetë identifikuar një fëmijë dhe të jetë referuar rasti pranë shërbimit social, menaxherët e rastit në punën sociale duhet të ndihmojnë në përcjelljen e fëmijëve përmes sistemit dhe drejt shërbimeve të caktuara. Standardet minimale të Kosovës për shërbimet sociale rregullojnë numrin maksimal të rasteve që një menaxher i rasteve të mund të mbajë në të njëjtën kohë. Megjithatë, menaxherët e rasteve brenda Qendrave për Punë Sociale janë të mbingarkuar me raste të fëmijëve, për shkak të numrit të vogël të punëtorëve social në QPS dhe numrit të madh të fëmijëve që kanë nevojë për shërbime. [Prandaj rekomandohet që Kosova të rrisë kapacitetet dhe investimet financiare në shërbimet sociale për zbatimin e politikave, ligjeve dhe rregulloreve që mbrojnë fëmijët nga dhuna.](#)

Kosova sponsorizon një mori shërbimesh për viktimat e dhunës që ofrohen nga OJQ të ndryshme. Mirëpo, kufizimet financiare dhe mungesa e ndarjes së një buxheti të caktuar për shërbimet sociale kufizojnë shkallën dhe kualitetin e ofrimit të këtyre shërbimeve. Në përgjigje ndaj numrit të fëmijëve që kanë nevojë për kujdes dhe shërbime, shumë qendra të kujdesit rezidencial dhe ditor që veprojnë si organizata të shoqërisë civile po ballafaqohen me probleme të qëndrueshmërisë financiare dhe me rrezik për mbylljen e ofrimit të këtyre shërbimeve. Fëmijët që përfitojnë nga shërbimet janë të detyruar të transferohen nga një formë e kujdesit në një tjetër, gjë që përbën shkelje serioze të të drejtave të fëmijës sepse kjo mund të ketë ndikim negativ në zhvillimin fizik dhe psikologjik të tyre⁹. [Për këtë arsye, ndërhyrja është e nevojshme për të krijuar standarde financiare për shërbimet sociale dhe për të miratuar buxhetet që mundësojnë financimin e qëndrueshëm të shërbimeve të financuara përmes MPMS dhe Komunave.](#)

Koordinimi i shërbimeve përmes menaxhimit të rasteve është një nga shumë mekanizmat koordinues të nevojshëm. [Rekomandohet që Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë i themeluar me vendim të Kryeministrit ti jipet mbikëqyrja dhe autoriteti i duhur për të punuar së bashku me agjencitë qeveritare dhe për të deleguar detyra të gjitha këtyre agjencive.](#)

Në anën tjetër, MASHT ka krijuar një mekanizëm raportimi të dhunës ndaj fëmijëve në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Informatave Arsimit (SMIA). Qeveria ka aprovuar një Protokoll¹⁰ që synon parandalimin, identifikimin dhe referimin e rasteve të dhunës si një përpjekje për të koordinuar profesionistët përkatës përgjegjës në të gjitha fazat e mbrojtjes së fëmijëve (duke përfshirë ofrimin e shërbimeve për fëmijët viktime të dhunës). Megjithatë, zbatimi i protokollit

mbetet i dobët, prandaj rekomandohet që të rriten kapacitetet e profesionistëve të arsimit për zbatimin e protokollit.

Procedurat standarde të veprimit për viktimat e dhunës ekzistojnë që nga viti 2013. Rekomandohet që trajnimet për menaxhimin e rasteve të shtrihen tek aktorët e agjencive të arsimit, shëndetësisë dhe drejtësisë në mënyrë që ata të njihen me procedurat standarde të veprimit për viktimat e dhunës dhe që mekanizmat ekzistues të dihen, pranohen dhe të jenë relevant në proceset e vendimmarrjes. Gjithashtu, rekomandohet që Kosova të fuqizojë Grupin Koordinues Ndërmintoror Kundër Dhunës në Familje.


Përkundër faktit se Kosova ka bërë progres në vendosjen e mekanizmave të inspektimit, siç është Njësia e Inspektimit në kuadër të Departamentit të Politikave Sociale dhe Familjeve në MPMS, kjo njësi nuk është një organ i pavarur në ofrimin e shërbimeve. Rekomandohet që Kosova, përveç ofruesve të shërbimit, të krijojë një organ të pavarur inspektimi për të monitoruar cilësinë e ofrimit të shërbimeve.

Shfrytëzimi ekonomik

Neni 32 i KDF kërkon që Shtetet Palë të njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror. Ky nen rreptësisht ndalon punën e fëmijëve dhe kërkon që Shtetet Palë të përcaktojnë moshën minimale për punësim, të definojnë orët dhe kushtet për punësimin e pranueshëm të të rinjve dhe të krijojnë mekanizma zbatues me qëllim që të nxitet përputhshmëria nga ana e të gjithë aktorëve potencial.

Indeksi ka bërë matjet dhe ka krahasuar pesë dimensionet e veprimeve të qeverisë për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik: politikat, shërbimet, kapacitetin, koordinimin dhe llogaridhënien.

Në veprimet e saj për të luftuar shfrytëzimin ekonomik, Kosova ka shënuar rezultatin prej 0,576 nga totali i vlerësimit prej 1.0 gjë e cila tregon se ka vend për përmirësim. Veprimet e Kosovës për të luftuar shfrytëzimin ekonomik janë më të dukshme në fushën e ligjeve dhe politikave të saj (0,758). Megjithatë, rezultatet e Kosovës në kapacitet dhe në punën për të ndërtuar shërbime të përshtatshme mbeten të kufizuara, respektivisht me 0,442 dhe 0,500.



Llogaridhënia ndaj përfituesve, familjeve dhe aktorëve të tjerë është e ulët me një rezultat prej 0,589 dhe koordinimi me 0,321. Ekziston një mospërputhje e madhe ndërmjet legjislacionit dhe të gjitha dimensioneve të tjera të zbatimit të politikave.

Rezultatet e indeksit tregojnë se Kosova ka bërë përpjekje në adresimin e çështjes së shfrytëzimit ekonomik edhe pse ka ende vend për përmirësim. Kosova ka miratuar ligjet e saj vendore për t'i përafuar ato me detyrimet dhe përkufizimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës - ILO (duke përfshirë format më të rënda të punës, moshën dhe standardet që pengojnë fëmijët që të angazhohen në punë të rrezikshme) pavarësisht faktit se nuk ka ratifikuar Konventën e ILO për Punën e Fëmijëve për shkak të statusit të tanishëm politik ndërkombëtar. Kosova ka miratuar Strategjinë Nacionale dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve 2011 - 2016.

Ashtu sikur edhe për çështjet e tjera të mbuluara nga Indeksi, edhe për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të shfrytëzimit ekonomik ka kapacitete të kufizuara. Bazuar në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, 10.7 përqind e fëmijëve në Kosovë janë të përfshirë në punë të rënda, ndërsa 6.8 përqind e tyre janë duke punuar në kushte të rrezikshme¹¹. Në të njëjtën kohë, të dhënat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale tregojnë se në vitin 2016, shteti ka identifikuar, në nivel vendi, vetëm 62 raste të fëmijëve të përfshirë në punë¹². [Rekomandohet që Kosova të rrisë shkallën dhe burimet që u ofrohen Qendrave për Punë Sociale për të identifikuar rastet e fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme.](#)

Ekzistojnë kufizime të konsiderueshme të kapaciteteve për punë në identifikimin dhe rritjen e raportimit të rasteve të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve. Qendrat për Punë Sociale nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime adekuate dhe cilësore për shkak të mungesës së burimeve njërezore dhe financiare. Në përgjithësi, ka mungesë të shërbimeve, programeve të rehabilitimit dhe reintegrimit për fëmijët e përfshirë në punë. Pa koordinimin e punëve nga punëtorët social dhe

marrjen e rolit udhëheqës nga ana e tyre, aktorët dhe burimet e tjera nuk mund të shfrytëzohen sa duhet. Shteti nuk ofron ose nuk sponsorizon shërbime standarde të qasshme që mbulojnë gjithë vendin për të siguruar: identifikimin, vlerësimin, mbështetjen, hetimin dhe përcjelljen, vendosjen në vende të mbrojtura, rehabilitimin fizik, rehabilitimin psikologjik dhe reintegrimin social të fëmijëve viktime të shfrytëzimit ekonomik. [Rekomandohet rritja e investimeve financiare për të siguruar identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë në mbarë Kosovën, duke përfshirë zonat më të largëta rurale ku aktualisht shërbimet nuk janë të qasshme.](#)

Përveç QPS, edhe Inspektorati i Punës, një agjenci tjetër e ngarkuar me detyrë për të identifikuar rastet e fëmijëve të përfshirë në punë për të reaguar në ato vende të punësimit që mund të jenë në kundërshtim me ligjin, nuk është i pranishëm në të gjitha komunat dhe është i kufizuar në staf dhe kohë. [Rekomandohet rritja e kapaciteteve të këtyre institucioneve të cilat aktualisht janë të kufizuara në staf dhe burime me qëllim që t'u mundësohet identifikimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme.](#)

Gjithashtu, fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme nuk janë të vetëdijshëm për mundësinë e vetë-raportimit ose atë të raportimit të bashkëmohatarëve. Rekomandohet që Kosova të vërë në përdorim mekanizma të tillë dhe të rrisë vetëdijen dhe ofrojë informata rreth përdorimit të tyre. Rekomandohet që Kosova të rrisë numrin e vendeve në të cilat mund të bëhet vetë raportimi dhe raportimi i bashkëmohatarëve për rastet e shfrytëzimit ekonomik.


Koordinimi ndërmjet agjencive për përgjigje efektive ndaj shfrytëzimit ekonomik është gjithashtu i kufizuar në shtrirje dhe sukses. Në vitin 2016, Komitetet Lokale për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve nuk kanë funksionuar. [Për këtë arsye rekomandohet që Komitetet Lokale për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve, me qëllim të rritjes së identifikimit dhe zhvillimit e mekanizmave të duhur të raportimit, të fillojnë punën në krijimin e një koordinimi efektiv ndërmjet autoriteteve relevante.](#)

Po ashtu, hap i rëndësishëm për të trajtuar një fenomen të tillë është edhe rritja e informacioneve për përhapjen e rasteve të shfrytëzimit ekonomik. Aktualisht, Kosova nuk ka një bazë të të dhënave në nivel nacional ku raportohen rastet e fëmijëve që janë viktime të shfrytëzimit ekonomik. [Rekomandohet që Kosova të krijojë dhe të funksionalizojë mekanizmat përkatës vendor për grumbullimin e të dhënave për të ndërtuar dhe zhvilluar një bazë të të dhënave në nivel nacional të ndara sipas gjinisë, moshës, llojit të punës dhe aftësisë së kufizuar. Kjo do të ndihmonte në shtimin e vëmendjes ndaj përhapjes së kësaj çështjeje.](#)

Shfrytëzimi seksual

Neni 34 i KDF kërkon që Shtetet Palë të mbrojnë vajzat dhe djemtë prej shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Konventa kërkon që shtetet të parandalojnë abuzimin e fëmijëve përmes prostitucionit dhe pornografisë dhe të parandalojnë veprimet (shtrënguese ose të tjera) që angazhojnë fëmijët në aktivitete seksuale të jashtligjshme. Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet, përfshirë veprimet e përbashkëta me Shtetet Palë të tjera për të parandaluar këtë lloj të shfrytëzimit.

Kosova shënon rezultat të lartë në veprimet për parandalimin dhe ndalimin e shfrytëzimit seksual përmes ligjeve dhe politikave me rezultat prej 0,808 dhe koordinimit me 0,957. Në ndërkohë, rezultatet e Kosovës sa i përket kapacitetit (0,699), shërbimeve (0,687) dhe llogaridhënies (0,462) janë të ulëta krahasuar me dimensionet tjera të veprimeve qeveritare.



Edhe pse ligji dhe politika e Kosovës shënon rezultate të larta sa i përket ndalimit të shfrytëzimit seksual, në këtë drejtim duhet të punohet ende. Kodi penal¹³ nuk i pengon personat e dënuar për vepra të dhunshme dhe abuzimin seksual të fëmijëve që të punojnë me fëmijë. Prandaj, rekomandohet fuqishëm që të ndryshohet Kodi Penal ashtu që puna me fëmijë e personave të dënuar për vepra të dhunshme dhe abuzim seksual ndaj fëmijëve, të ndalohet. Gjithashtu, ligjet e Kosovës duhet të bëjnë një hap më tutje drejt kontrollit të historikut penal për të gjithë personat që punojnë me fëmijë dhe/apo janë në kontakt me ta.

Gjithashtu, duhet të zgjerohet edhe përkufizimi ligjor i Kosovë për shfrytëzimin seksual. Korniza ligjore ende nuk ofron masa për parandalimin e shfrytëzimit të fëmijëve përmes “telefonatave seksuale”. Rekomandohet që Kosova të njohë ligjërisht shfrytëzimin e fëmijëve përmes “telefonatave seksuale” dhe përmes Kodit Penal të ndalojë një shfrytëzim të tillë. Pa një ndalesë të tillë, një sjellje e tillë nuk do të hetohet apo sanksionohet.

Për më tej, Kosova nuk e ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual. Ajo nuk ka nënshkruar ndonjë konventë tjetër ndërkombëtare për shkak të statusit të saj ndërkombëtar duke përfshirë edhe Konventën e Budapestit 2001 për Krimin Kibernetik.

Ka mungesë të mekanizmave të pavarur monitorues për monitorim dhe vlerësim të rregullt dhe për t'i mbajtur institucionet relevante përgjegjës për mandatin e tyre. Për të rritur cilësinë e rezultateve të punës së këtyre organeve, rekomandohet fuqishëm krijimi i një mekanizmi të pavarur inspektimi jashtë kontrollit të qeverisë.

Në hetimin e kryerësve të veprave, Kosova ofron mbrojtjen e dëshmitarëve fëmijë në rastet e trafikimit dhe ju mundëson dëshmitarëve mbështetje, këshillim dhe mbrojtje¹⁴. Në kuadër të procedurës penale ekziston një qasje më e përgjithshme sa i përket rasteve të shfrytëzimit seksual jashtë fushës së trafikimit. Rekomandohet që Kosova të rishikojë Kodin e Drejtësisë për të Mitur për të verifikuar që fëmijët dëshmitarë në rastet e shfrytëzimit seksual, që nuk janë raste të trafikimit me njerëz, të kenë mbrojtje dhe mbështetje të duhur gjatë ndjekjes penale të shkelësve të dyshuar.


Shërbimet e rehabilitimit të Kosovës për fëmijët viktime të shfrytëzimit seksual ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile me financim të pjesshëm nga shteti. Siç dëshmohet nga rezultati i shërbimit, ato duhet të përmirësohen dhe të jenë të qëndrueshme për të garantuar rehabilitimin dhe reintegrimin e duhur dhe të nevojshëm të fëmijës. Shteti nuk planifikon plotësisht dhe nuk zbaton programe për rehabilitimin dhe reintegrimin e fëmijëve që janë viktime të shfrytëzimit seksual. Për shkak se nuk ka standarde financiare për këto shërbime, alokimet buxhetore nuk janë në linjë me nevojën, duke kufizuar trajtimin dhe kujdesin. [Rekomandohet që Kosova të miratojë standarde financiare për të siguruar financim të qëndrueshëm të harmonizuar me standardet minimale të cilësisë.](#)

[Ka nevojë për fuqizimin e mekanizmave për identifikim dhe raportim që do të lehtësojnë vetë-raportimin, raportimin e bashkëmoshatarëve dhe qasjen në raportim të profesionistëve të cilët vazhdimisht punojnë me fëmijët dhe të rinjtë \(p.sh. mësimdhënësit, psikologët e shkollave, këshilluesit\).](#) Për shkak se jo të gjitha rastet e shfrytëzimit seksual përfshijnë edhe trafikimin, ende ka nevojë për zhvillimin e llojeve të tjera të mekanizmave të ankesave miqësor me fëmijët, që do të adresonin të gjitha mënyrat e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Linja nacionale telefonike për raportimin e rasteve të dhunës dhe abuzimit është e hapur për njerëzit e të gjitha moshave dhe përfshin të gjitha situatat e abuzimit. Stafit nuk trajnohet veçanërisht për këshillimin e fëmijëve. [Rekomandohet që Kosova të rrisë numrin e vendeve të cilat mundësojnë vetë raportimin dhe raportimin e bashkëmoshatarëve në situata të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.](#)

Trafikimi

Neni 35 i KDF kërkon që Shtetet Palë të mbrojnë vajzat dhe djemtë nga rrëmbimi, shitja ose trafikimi i personave. Konventa kërkon nga shtetet që të parandalojnë dhe t'i japin fund përdorimit të fëmijëve në prostitucion dhe pornografi dhe të parandalojnë veprimet (shtrënguese ose të tjera) e përfshirjes së fëmijëve në veprimtari seksuale të paligjshme. Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë veprimin e përbashkët me Shtetet Palë të tjera, për të parandaluar këtë lloj të shfrytëzimit.

Kosova ka arritur rezultatin prej 0,673 nga rezultati i mundshëm prej 1.0 në veprimet e saj për të parandaluar rrëmbimin, shitjen ose trafikimin e fëmijëve. Kosova ka arritur rezultate të larta në veprimet për parandalimin dhe ndalimin e shfrytëzimit seksual përmes ligjeve dhe politikave (0,781) dhe koordinimit (0,921). Rezultatet e Kosovës për kapacitetin (0,691) dhe shërbimet (0,625) janë më të ulëta, ndërsa rezultati i llogaridhënies (0,511) mbetet më i ulëti.



Për shkak të statusit të saj ndërkombëtar, Kosova nuk ka ratifikuar ose nuk ka aderuar në Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve (2000), Protokollin për Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkrimin e Trafikimit të Personave veçanërisht të grave dhe fëmijëve në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (2000), Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve (1980), Konventën Shtesë për Heqjen e Skllavërisë, Tregtisë së Skllavërve dhe Institucioneve dhe Praktikave të ngjashme me Skllavërinë (1956) dhe Konventën për Ndalimin e Trafikut të personave dhe Shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve (1949).

Megjithatë, ligjet e brendshme të Kosovës ndalojnë të gjitha format e trafikimit dhe shitjes së personave. Gjithashtu, ligjet e brendshme të Kosovës përfshijnë ndalimin e punës së detyruar, kërkimin e lëmshës dhe shitjen e organeve. Kosova, si shtet i origjinës ose i destinacionit, është palë në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe që kërkojnë partneritet me vendet e tjera.

Për të rritur rezultatet e Kosovës lidhur me ligjin dhe politikat në lidhje me trafikimin, Kosova duhet të zgjerojë licencimin e shërbimeve (qofshin këto shërbime të rehabilitimit dhe reintegrimit, këshillimit, etj.) duke përfshirë edhe shërbimet publike të ofruara nga shteti. Aktualisht, vetëm shërbimet e ofruara nga subjektet private ose jo-fitimprurëse detyrohen të kërkojnë licencim. Meqë licencimi mundëson rritjen e llogaridhënies për këto shërbime, atëherë të gjitha shërbimet, pa marrë parasysh ato publike apo private, duhet të licencohen.

Kosova ofron shërbime ekskluzivisht për viktimat e trafikuar dhe shërbime të tjera më të përgjithshme për të gjitha viktimat e dhunës dhe shfrytëzimit. Viktimat, anonimiteti i të cilave është i domosdoshëm për sigurinë e tyre, konsiderohen si raste me rrezikshmëri të mesme ose të lartë dhe mund të kërkojnë mbrojtje brenda një strehimoreje të mbyllur që udhëhiqet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Për viktimat e trafikuar që konsiderohen raste me rrezikshmëri të ulët, shteti ofron financime të pjesshme për OJQ të licencuara për të operuar. Financimi është i kufizuar, që nënkupton veprime pothuajse simbolike dhe që nuk mund t'i mbështesin këto shërbime. Për shkak të rënies edhe të financimeve nga donatorët ndërkombëtarë në shërbimet e mbrojtjes sociale në Kosovës, deficieti financiar paraqet një shqetësim në vete¹⁵. [Për hapat e mëtejshëm, rekomandohet që Kosova të miratojë standardet financiare për të gjitha shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve viktimat të trafikimit dhe ndarjen e buxheteve në linjë me këto standarde.](#)

Sa i përket kapacitetit institucional, Qendrat për Punë Sociale nuk kanë as numrin adekuat të personelit për të kryer detyrat e tyre dhe as shkathtësitë e nevojshme për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve viktime (nuk ka psikologë ose staf tjetër të aftë për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve të abuzuar nga trafikimi). **Rekomandohet rritja e stafit profesional për të ofruar shërbime psikologjike për të siguruar qasjen multidisiplinare.** QPS-të punojnë me të gjitha kategoritë e cënueshme të fëmijëve dhe të rriturve; në të gjitha situatat, nuk ka njësi të posaçme ose profesionistë të specializuar të dedikuar për të punuar me fëmijët ose me kategori të cënueshme të veçanta. **MPMS duhet të bëjë reformimin dhe ristrukturimin e QPS për të ndërtuar një fuqi punëtore të aftë për t'ju përgjigjur cënueshmërive të caktuara dhe e ndarë për të menaxhuar veç e veç rastet e fëmijëve dhe rastet e të rriturve.**

Parandalimi i trafikimit dhe mbrojtja e fëmijëve të trafikuar varet në forcën e ndjekjes penale; për të zvogëluar përhapjen e trafikimit, në sistemin e drejtësisë penale duhet të ekzistojë një element i ndëshkimit po aq sa edhe i rehabilitimit. Sipas Raportit për Trafikimin me Njerëz për Kosovën në 2016¹⁶, i Departamentit Amerikan të Shtetit, gjyqtarët po japin dënime të lehta ndaj trafikantëve të dënuar ndërsa prokurorët vazhdojnë të degradojnë rastet e trafikimit në krime më të vogla. **Rekomandohet që vendimmarrësit e drejtësisë penale në Kosovë t'i japin prioritet hetimeve dhe ndjekjeve penale të trafikantëve të dyshuar për të ndërtuar raste të forta dhe maksimizuar dënimet kurdo që është e mundur.** Ekziston nevoja për të vënë nën objektiv edhe zyrtarët e përfshirë; për të caktuar prokurorë dhe gjyqtarë të posaçëm për të trajtuar rastet e trafikimit; për të ofruar trajnime të avancuara për zyrtarët që merren me hetimet dhe ndjekjet e trafikimit dhe, në koordinim me policinë, për të identifikuar dhe ndihmuar fëmijët që i nënshtrohen detyrimit për kërkim lëmshë. Për të theksuar llogaridhënien ndaj prokurorisë dhe drejtësisë, gjithashtu është e rëndësishme që Kosova të standardizojë mbledhjen e të dhënave dhe të krijojë një bazë të dhënash për të siguruar statistika të ndara për trafikimin dhe ndjekjet e dënimet lidhur me trafikimin. Në fund, Kosova duhet të zbatojë në tërësi Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit që i ndihmon viktimat të rehabilitojnë jetën e tyre.

Rezultati i Kosovës sa i përket llogaridhënies për trafikimin është i ulët, pjesërisht edhe për shkak të mungesës së mekanizmave të pavarur të monitorimit. Për shkak se cilësia e të gjitha shërbimeve qeveritare nuk i nënshtrohet monitorimit dhe vlerësimit të jashtëm, por më tepër Njësisë së Brendshme për Monitorim dhe Inspektim brenda MPMS, çështja e pavarësisë dhe llogaridhënies publike është vënë në pyetje. **Prandaj rekomandohet që Kosova të krijojë një panel të pavarur inspektimi i cili do të kryhej nga një entitet jashtë kontrollit të qeverisë dhe i cili do të mundësonte llogaridhënie rigoroze nga ana e profesionistëve dhe institucioneve që janë të mandatuara për të ofruar shërbime të tilla.**

Për t'i shërbyer më mirë fëmijëve të rrezikuar nga trafikimi, politikat dhe praktikat e shtetit duhet të adresojnë trendet brenda këtij abuzimi. Indeksi e pranon se shteti, gjatë 3 viteve të fundit, nuk ka filluar ose sponsorizuar ndonjë hulumtim në nivel nacional mbi trafikimin e fëmijëve. Hulumtime të tilla mund të ofrojnë njohuri dhe të dhëna të reja për të lehtësuar një politikëbërje më të fuqishme dhe më mirë të orientuar. **Prandaj rekomandohet që Kosova të bëjë hulumtime të rregullta në nivel nacional për trafikimin e fëmijëve për të planifikuar dhe zbatuar më mirë programet e duhura të ndërhyrjes në parandalimin, mbrojtjen dhe reintegrimin e fëmijëve në rrezik dhe viktime të trafikimit.**


Në përputhje me të dhënat më të mira në dispozicion, është me rëndësi të forcohet roli i Autoritetit Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz që operon brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me një zyrë të tillë më të fuqishme, bashkëpunimi më i mirë në Kosovë mes ministrive dhe niveleve të tjera të qeverisë do të ishte më i mundshëm.

Kujdesi dhe mbrojtja Aftësia e kufizuar

Neni 23 i KDF pranon se fëmijët me aftësi të kufizuara shpeshherë kanë nevojë për burime dhe kujdes shtesë në mënyrë që të gëzojnë jetë të plotë dhe dinjitoze. Për këtë arsye, neni 23 krijon obligim të veçantë për mbrojtjen dhe promovimin e mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.

Kosova ka arritur rezultatin prej 0,375 nga pikët e mundshme prej 1.0 në veprimet e saj për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Edhe pse Kosova ka arritur rezultat relativisht të lartë në veprimet e ndërmarra në legjislacion dhe politika për aftësinë e kufizuar (0,743), të gjitha rezultatet e dimensioneve të tjera të Indeksit: ai i shërbimeve (0,283), kapaciteteve (0,260), llogaridhënies (0,324) dhe koordinimit (0,250), janë shumë të ulëta.

Siç dëshmohet nga rezultati i saj në ligje dhe politika, Kosova ka bërë përparim në nxjerrjen e ligjeve të saj sipas konventave për aftësitë e kufizuara dhe të drejtave të fëmijëve, duke nxjerrë Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara¹⁷ dhe duke mandatuar një organ koordinues në nivel nacional për të punuar drejt zbatimit të saj. Sfidat tani mbesin për të zgjeruar shtrirjen e masave të ndërmarra në të gjitha nivelet: legjislacion, strategji si dhe funksionim dhe forcim të organeve qeveritare në mënyrë që të drejtat për aftësitë e kufizuara të bëhen funksionale.



Kosova ka përcaktuar të drejtën për ndihmë në të holla për fëmijët me aftësi të kufizuara si element të mbrojtjes për këtë kategori të prekur. Megjithatë, hapi i fuqishëm i përkrahjes së Kosovës i theksuar në Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara¹⁸ ka dështuar për të patur ndonjë ndikim të mundshëm meqë ai nuk garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, por njeh të drejtën për kompensim material vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme.

Prandaj, si i tillë ai bën diskriminim dhe nuk mbulon fëmijët me aftësi të kufizuara të përkohshme dhe as fëmijët me aftësi të kufizuara të pjesshme. Për më tepër, mbështetja financiare prej 100 euro që u ofrohet fëmijëve dhe familjeve të tyre është e pamjaftueshme për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. [Rekomandohet që MPMS të ndryshojë Ligjin për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për të përfshirë mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara të pjesshme.](#)

Kosova është kujdesur që të krijojë standarde minimale të shërbimeve dedikuar fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky është një hap shumë i rëndësishëm për të ruajtur cilësinë e kujdesit. Megjithatë, zbatimi i standarteve është i nivelit të ulët për shkak të kufizimeve financiare me të cilat përballen shumica e këtyre institucioneve. [Për këtë arsye, rekomandohet që Kosova të krijojë standarde financiare për shërbimet që përputhen me standardet e cilësisë të hartuara për fëmijët me aftësi të kufizuara.](#)

Në nivel komunal, shërbimet sociale në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara janë shumë të kufizuara. Janë bërë përpjekje që qendrat e kujdesit ditor të operojnë (të administruara nga OJT-të), por shërbimet e tilla kanë mbetur kryesisht nën mbështetjen e agjencive dhe donatorëve të huaj, ndërkohë që mbështetja shtetërore nuk është e strukturuar, nuk është e qëndrueshme dhe në të njëjtën kohë mbetet shumë e kufizuar dhe pa një qasje afatgjatë. Për më tepër,

këto shërbime janë të kufizuara sa i përket fushëveprimit të tyre në komuna dhe lokacione të caktuara. Natyra sporadike e këtyre shërbimeve minimizon përfshirjen e plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe kufizon një plan afatgjatë rehabilitimi të nevojshëm që ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuara të përmbushin potencialin e tyre. Ekzistojnë disa përjashtime ku MPMS ka ofruar mbështetje financiare për disa OJQ por përsëri këto shërbime nuk mbulojnë gjithë territorin dhe nuk ofrojnë ndihmë standarde. [Rekomandohet që përmes nën-kontraktimit të OJQ-ve lokale, Kosova të përshkallëzojë dhe sponsorizojë shërbimet sociale të bazuara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara që u përgjigjen nevojave të veçanta të tyre në ofrimin e shërbimeve të përditshme psiko-sociale, të socializimit, rehabilitimit dhe riintegritit.](#)

Gjithashtu, KDF kërkon që Shtetet Palë të ofrojnë trajtimet e nevojshme mjekësore dhe shëndetësore për të tejkaluar dhe për t'u përballur me aftësinë e kufizuar. Sa i përket kujdesit shëndetësor, mungojnë barnat esenciale, materialet shpenzuese, shërbimet shëndetësore dhe pajisjet ndihmëse për fëmijët me aftësi të kufizuara. [Kosova duhet të garantojë shërbime cilësore shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara nëpërmjet sigurimit të rregullt të barnave, materialeve shpenzuese dhe pajisjeve të domosdoshme për këta fëmijë.](#)

Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, sa i përket qasjes së tyre në arsim, janë të përfshira në Ligjin për Arsimin Parauniversitar¹⁹. Ka mungesë të vullnetit institucional në planifikimin e buxhetit për zbatimin e ligjeve dhe strategjive në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Prioritetet që lidhen me këto investime janë kryesisht të orientuara në investime kapitale, ndërsa për infrastrukturën fizike, asistentët, mësuesit që udhëtojnë dhe transportin e fëmijëve të regjistruar në sistemin e arsimit të rregullt, nuk ka ndarje të fondeve të nevojshme. [Buxhetet duhet të jenë në përputhje me planet, ligjet dhe strategjitë që shkojnë përtej investimeve kapitale dhe që mbështesin nevojat për infrastrukturë fizike, asistentë, ngritjen e kapaciteteve për mësimdhënës dhe nevojat e transportit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.](#) Është e rëndësishme të kuptojmë se cilat janë investimet financiare të domosdoshme për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë. Për shembull, mësimdhënësit edhe më tej nuk kanë trajnimet dhe burimet e nevojshme që në mënyrë të vazhdueshme të përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara. [Rekomandohet të rritet stafi profesional në arsimin gjithëpërfshirës, përcaktimi i kodit buxhetor për ndihmën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, sigurimi i specialistëve të trajnuar e të kualifikuar brenda arsimit.](#) Tanimë në kuadër të Universitetit Publik ekziston programi për master mbi arsimin gjithëpërfshirës. [Duhet vënë në dispozicion më shumë trajnime për të njohur stafin mësimdhënës me rëndësinë e përdorimit të metodologjive arsimore gjithëpërfshirëse në hartimin dhe dhënien e mësimëve.](#)

Gjithashtu, arsimi gjithëpërfshirës është i mundur vetëm kur prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë informacionin dhe mbështetjen e duhur. Aktualisht, për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, informatat janë të kufizuara. Mbështetja, ndihma për prindërit si dhe shtrirja për tek ta është e ulët, e fragmentuar dhe kryesisht e kufizuar në iniciativat nga shoqëria civile. Pa shërbime adekuate dhe të përshtatshme në nivel lokal, shumë familje ndihen të paafta në mbështetjen e zhvillimit psikosocial të fëmijëve të tyre, rehabilitimin fizik në shtëpi dhe përfshirjen e tyre në shkolla dhe në jetën e komunitetit.

Për të gjitha objektet publike, infrastruktura fizike në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara duhet të kërkohet dhe të bëhet prioritet. Politikat përkatëse që rregullojnë këtë çështje janë tashmë në fuqi por ato ende nuk janë vënë në praktikë (p.sh. në spitale, shkolla, gjykata, kuvende komunale dhe në Qendrat për Punë Sociale). [Rekomandohet që Kosova të heqë barrierat e qasjes publike, transportit, komunikimit, informatave në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje në arsim të duhur dhe në jetën shoqërore, me qëllim të zvogëlimit të izolimit dhe varësisë.](#)

Së fundmi, të dhënat për numrin e saktë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë janë të kufizuara pasi nuk ka ende një institucion publik që i mbledh këto të dhëna. Mungesa e të dhënave të centralizuara në nivel nacional, kufizon planifikimin e përgjegjshëm dhe zhvillimin e programeve mbështetëse për ndërhyrje. [Rekomandohet që Kosova të grumbullojë të dhëna dhe të zhvillojë një bazë të të dhënave në nivel nacional për të përcaktuar numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara me të dhëna të ndara sipas moshës, gjinisë, llojeve të aftësisë së kufizuar dhe komunës.](#)


Rezultatet lidhur me fëmijët e ndarë nga prindërit

Tre seksionet në vijim masin përpjekjet e qeverisë për menaxhimin e ndarjes së fëmijës nga prindërit e tij/saj, në tre faza të ndryshme. Qëllimi i parë i shtetit dhe institucioneve është parandalimi i ndarjes së familjes dhe mundësia që fëmija të rritet dhe të zhvillohet në familjen e tij/saj, pasi që jeta jashtë familjes biologjike krijon një numër shtesë të rreziqeve të fëmijët. Megjithatë, përkundër përpjekjeve që bëhen për të mbajtur familjet së bashku, jo të gjitha familjet biologjike janë të sigurta dhe ofrojnë një zhvillim të duhur të fëmijëve. Në raste të tilla, shteti rezervon të drejtën për të ndarë fëmijën nga familja biologjike duke u përfshirë në mënyrë proaktive me institucionet dhe profesionistët e mandatuar të tij, në mënyrë që të identifikojë nevojat, të sigurojë mbrojtje dhe kujdes dhe krijojë një mjedis pozitiv dhe të ngrohtë për rritje dhe zhvillim. Pa angazhimin proaktiv të mbrojtësve dhe rrjeteve të duhura të sigurisë sociale, fëmijët jashtë kujdesit familjar nuk arrijnë të marrin kujdesin dhe mbrojtjen bazë për të nxitur zhvillimin, reintegrimin dhe mirëqenien afatgjatë. KDF parashton obligime të qarta për Shtetet Palë duke siguruar që ato, së pari duhet të punojnë për të parandaluar ndarjen e fëmijëve dhe prindërve, për aq kohë sa kujdesi prindëror është në interesin më të mirë të fëmijës. Nëse ndarja kërkohet për të mbrojtur fëmijën, Shtetet Palë duhet të përcjellin protokolet e veçanta për t'i mbajtur fëmijët të sigurt dhe për të inkurajuar një rrugë të fortë zhvillimi për fëmijën. Nëse ndarja do të jetë e përhershme, KDF rekomandon një familje tjetër alternative apo një mjedis të bazuar në komunitet, për zhvillimin e fëmijës. Përfundimisht, KDF vendos përgjegjësinë për kujdes ndaj fëmijës i cili jeton në rrugë pa familje ose pa shtëpi.

Parandalimi i ndarjes – Ndhimja e dhënë familjeve për të qëndruar së bashku

Siç u përmend më lart, neni 9 i KDF adreson ndarjen e prindërve dhe fëmijës duke i krijuar shtetit tre obligime të veçanta. Ajo kërkon që Shtetet Palë të ofrojnë shërbime dhe mbështetje për familjet, gjithmonë me qëllim të mbajtjes së njësisë familjare së bashku. Së dyti, kërkon që Shtetet Palë t'i ndajnë prindërit nga fëmijët vetëm kur ndarja është në interesin më të mirë të fëmijës. Së treti, kërkon që Shtetet Palë të ndihmojnë prindërit dhe fëmijët të mbajnë kontakte në rastet kur ata ndahen.

Kosova ka arritur rezultatin total prej 0,624 nga rezultati i mundshëm 1.0. Kosova ka arritur rezultate relativisht të larta në nivelin e politikave me rezultat prej 0,779 dhe në nivelin e koordinimit me 0,833. Megjithatë, Kosova ka arritur rezultate më të ulëta në fushën e shërbimit (0,545), llogaridhënies (0,489) dhe kapacitetin e ofrimit të shërbimeve të duhura (0,513).



Shteti mund të luajë rol të rëndësishëm në parandalimin e ndarjeve të panevojshme. Legjislacioni i Kosovës, Ligji për Familjen²⁰ kërkon mbështetje për familjet për të parandaluar ndarjen e prindërve dhe fëmijëve. Mbështetja mund të përfshijë mirëqenien sociale (p.sh. ndihmën materiale), ndihmën psikologjike dhe veprimet për t'i kthyer fëmijët tek familjet e tyre në rast të ndarjes fizike.

Shërbimet parandaluese dhe reintegruese që i mbajnë familjet të bashkuara janë të dobëta për shkak të barrës së madhe të punës së QPS-ve si dhe të burimeve të pamjaftueshme, gjë që shpeshherë e kufizon fokusin vetëm në situatat dhe rastet emergjente. Për pasojë, parandalimi nuk ka shumë gjasa të jetë element thelbësor i misionit të QPS-së. Sidoqoftë, Qendrat për Punë Sociale kanë mandat ligjor për t'u ofruar këshillim prindërve në situata të ndarjes së fëmijëve dhe familjeve. Mirëpo, marrë parasysh numrin e kufizuar në staf, burime dhe kapacitete, ende mbetet sfida ofrimi i shërbimeve profesionale për të përmbushur nevojat. Për momentin, këto qendra punojnë me burime të kufizuara njerëzore dhe financiare dhe nuk i përmbushin në tërësi kërkesat sipas standardeve të cilësisë. Në anën tjetër, ekziston regjistri komunal që liston fëmijët që konsiderohen se janë në rrezik të neglizhimit, abuzimit ose shfrytëzimit. [Rekomandohet që stafi dhe burimet e disponueshme në QPS të rriten për të siguruar këshillimet për prindërit lidhur me regjistrin “në rrezik”²¹ dhe për familjet që tanimë janë ndarë.](#)

Aktualisht, shteti nuk u jep ndihmë materiale prindërve që përballen me situata krize me qëllim parandalimin e ndarjes së panevojshme. Sipas Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare²², shërbimet sociale dhe familjare të ofruara nga Qendra për Punë Sociale përfshijnë ofrimin e kujdesit të drejtpërdrejtë social, këshillimin ose, në rrethana të jashtëzakonshme, ndihmën materiale për të mirën e njerëzve në nevojë. Në praktikë ka raste kur ndihma financiare është dhënë por këto raste kanë të bëjnë me pranuesit e asaj ndihme të cilët gjenden nën nivelin e varfërisë. [Rekomandohet që Kosova të sigurojë ndihmën materiale për prindërit që përballen me situata krize që jo domosdoshmërisht jetojnë nën nivelin e varfërisë por përballen me një krizë financiare e cila mund të çojë në ndarje të panevojshme midis prindërve dhe fëmijës.](#)


Shmangia e ndarjes së familjes shpesh kërkon një kombinim të aktorëve të specializuar nga autoritetet kompetente (shërbimet sociale, drejtësia, shëndetësia dhe arsimi). Megjithëse koordinimi rezulton të jetë funksional, ai ende nuk është zhvilluar dhe zbatuar plotësisht. Këta aktorë të specializuar nuk kanë protokolet ose shprehitë profesionale për koordinimin e shërbimeve dhe proceseve për ato raste që kanë nevojë për ndërhyrje, hetime dhe përcjellje. Sidomos në procesin e parandalimit dhe përcjelljes, ekziston një zbrazëti më e madhe në koordinimin mes autoriteteve krahasuar me fazën e hetimit. [Për këtë arsye rekomandohet që Kosova të zhvillojë protokolet e koordinimit të plotë dhe të ofrojë nxitje për përdorimin e tyre në mesin e aktorëve dhe profesionistëve të specializuar për përcaktimin e qartë të detyrave, përshejtimin e shkëmbimit të informacionit, procesin e vendimmarrjes, ndërhyrjen dhe përcjelljen e rasteve. Protokolet e tilla do të ishin shumë të dobishme për ruajtjen e unitetit të familjes dhe fëmijës.](#)

Inicimi i ndarjes – Mbajtja e fëmijëve të sigurtë

Ndarja e prindit dhe fëmijës, inicohet kur ajo është në interesin më të mirë të fëmijës dhe kur qëndrimi në familjen biologjike e rrezikon zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.

Në përpjekjet e saj për t'i mbajtur fëmijët të sigurt nga iniciimi dhe përgjatë gjithë procesit të ndarjes, Kosova shënon rezultate prej 0,624 pikë nga 1.0 të mundshme. Veprimet e qeverisë për iniciim të ndarjes janë të shumëllojshme, me rezultat relativisht të lartë në ligje dhe politika prej 0,779 pikë dhe me rezultat në koordinim prej 0,833 pikë por me rezultate më të ulëta në shërbime (0,545), kapacitet (0,513) dhe llogaridhënie (0,489) nga ana e institucioneve gjatë zbatimit të ligjeve dhe ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

Korniza ligjore e Kosovës për ndarjen e prindërve me fëmijën vepron në përputhje me gjuhën e KDF, duke lejuar ndarjen si mjetin e fundit dhe vetëm atëherë kur një gjë e tillë është në interesin më të mirë të fëmijës²³. Punëtorët social të QPS-ve dhe organet gjyqësore, së bashku përcaktojnë nëse në raste specifike është përmbushur standardi i "interesit më të mirë".



Pas iniciimit të ndarjes, rastet dërgohen në gjykatë për vendimin përfundimtar. Megjithatë, për trajtimin e rasteve të ndarjes prind-fëmijë, Kosova nuk ka ndonjë gjykatë me gjyqtarë të specializuar. Në vend të kësaj, raste të tilla trajtohen nga gjykatat për rastet civile. **Rekomandohet hartimi dhe zbatimi i një programi të strukturuar dhe të vazhdueshëm të trajnimeve për të ndërtuar kapacitetet e një numri të caktuar të gjyqtarëve që do të trajtonin rastet e ndarjes së prindërve me fëmijë.**

Kosova organizon seanca të mbyllura gjatë procedimeve gjyqësore për të mbrojtur të drejtën e fëmijës në privatësi²⁴. Fëmijët, pa marrë parasysh moshën, kanë edhe të drejtën e pjesëmarrjes në procedime ku do të përcaktohet statusi i tyre²⁵. Mirëpo, nuk ka gjykata me gjyqtarë të specializuar për trajtimin e këtyre rasteve specifike. **Rekomandohet që Kosova t'u caktojë këto raste një numri të caktuar të gjyqtarëve. Gjyqtarët me përvojë dhe të trajnuar ofrojnë qëndrueshmëri më të madhe në vendime dhe janë në gjendje të veprojnë më mirë me fëmijët e përfshirë në raste të tilla.**


Për shkak të natyrës të ndjeshme të këtyre rasteve, është e domosdoshme për qeverinë të minimizojë vonesat në procedurat dhe vendimet për ndarjen e prindërve me fëmijët. Rastet konkrete tregojnë se fëmijët mund të mbeten në kujdes të përkohshëm alternativ për tri vite para se të merret vendimi përfundimtar për rastin e tyre. Zhvillimi i fëmijës, në anën tjetër, nuk lejon një vonesë të tillë pasi që mund të komprometojë marëdhënien ndërmjet fëmijës dhe kujdestarit²⁶. **Rekomandohet priorizimi i këtyre rasteve në listat e rasteve gjyqësore dhe gjyqtarët e caktuar të jenë të njoftuar dhe të trajnuar me/për kërkesat e këtyre procedurave. Koordinimi ndërmjet gjyqësorit, punës sociale, arsimit dhe shëndetësisë kërkon që rolet të paracaktohen dhe të kuptohet e pranohet afati kohor për veprime nga të gjitha palët e përfshira në proces.**

Në shërbime Kosova ka shënuar rezultate prej (0,545) pikë dhe rekomandohet që shërbimet sociale dhe familjare të jenë më të shumëllojshme, të rritet cilësia e shërbimeve që u ofrohen fëmijëve dhe familjeve në situatën e ndarjes së tyre nga ana e shërbimeve shtetërore si dhe nga sektori i OJQ-ve. [Ekziston nevoja për të pasuruar shërbimet sociale dhe shërbimet psiko-sociale për të siguruar një vlerësim më të mirë dhe më adekuat të gjendjes së fëmijës me qëllim të përcaktimit të formës më të mirë alternative të mbrojtjes, pavarësisht nëse do të ishte strehim tek të afërmit, strehim familjar, kujdes rezidencial apo adoptim. Në procesin e vendimmarrjes, pikëpamjet dhe mendimet e fëmijës duhet të merren në konsideratë.](#)

Pas ndarjes – Kujdesi për fëmijët e ndarë nga familjet e tyre

Shtetet duhet të ndërmarrin veprime për të ofruar mjedise të përshtatshme kujdesi për fëmijët e privuar nga mjedisi familjar dhe për të siguruar ofrimin e kujdesit të duhur familjar alternativ. Pasi fëmija të jetë ndarë nga prindërit e tij apo saj, Shtetet Palë kanë për detyrë të sigurojnë kujdes alternativ për fëmijët e ndarë nga familjet e tyre dhe të ndihmojnë në mbajtjen e kontaktit ndërmjet fëmijës dhe prindërve. Meqë KDF mban qëndrimin se lidhja dhe marrëdhënia ndërmjet prindërve dhe fëmijës është një e drejtë e rëndësishme e fëmijës dhe për shkak të faktit se lidhja familjare, sidomos atashimi prindëror nxit zhvillimin emocional të njeriut, ky nen përfshin edhe mundësimin dhe ndihmën në mbajtjen e kontaktit ndërmjet prindërve dhe fëmijës. Kjo kategori e Indeksit shënon përpjekjet e qeverisë për t'u kujdesur për fëmijët e ndarë nga familjet e tyre, siç kërkohet në nenin 20 të KDF.

Kosova ka shënuar rezultat prej 0,643 pikë nga ai i mundshëm prej 1.0, që do të thotë që fusha e ligjeve dhe praktikave të Kosovës sigurojnë mbrojtje të veçantë, ndihmë dhe kujdes alternativ për fëmijët e privuar nga mjedisi i tyre familjar, përfshirë strehimin familjar, strehimin tek të afërmit, adoptimin dhe strehimin rezidencial. Përpjekjet për të përmbushur këtë detyrim duhet të marrin në konsideratë historikun kulturor të fëmijës.



Rezultatet e Kosovës janë relativisht të larta në politika (0,722), në shërbime (0,695), në koordinim (0,785) dhe mesatarisht më të ulëta në llogaridhënie (0,570) dhe në kapacitet (0,548).

Në rrethanat e ndarjes së familjes dhe fëmijës, shqetësimi primar është komunikimi ndërmjet palëve pas ndarjes. Kosova i lejon fëmijët të mbajnë kontakte me familjet e tyre përdorëse janë të ndarë dhe përdorëse një kontakt i tillë i shërben interesave më të mirë të fëmijës. Gjykatat vendosin nëse vizitat (p.sh. të një prindi të divorcuar pa të drejtë kujdestarie ose një prindi në paraburgim) janë në interesin më të mirë të fëmijës. QPS-të monitorojnë, vizitojnë dhe raportojnë në gjykatë për zbatimin e vendimit të gjykatës²⁷.

Pasi të jenë ndarë nga familjet e tyre për interesin më të mirë të tyre, fëmijët vendosen në kujdes alternativ. Kosova nuk i mban fëmijët në institucione të mëdha rezidenciale të stilit "klasik". Kjo është një arritje shumë e madhe. Legjislacioni aktual, më saktësisht Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare²⁸, rregullon kujdesin alternativ për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror. Kosova mundëson kujdesin e përkohshëm derisa vendimi i gjykatës të përcaktojë kujdestarinë përfundimtare të një fëmije. Format alternative të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror janë: strehimi tek të afërmit, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi.

Kosova ka të zhvilluar strehimin familjar si formë e shërbimit të kujdesit alternativ. Shteti ofron 150 euro në muaj për fëmijë në familjen strehuese; ndërsa 75 euro në muaj i ofrohet një fëmije në strehim tek të afërmit. Kjo shumë ndryshon për fëmijët me aftësi të kufizuara në strehim familjar ku familjet strehuese marrin 250 euro në muaj për fëmijë. Megjithatë, nuk ka kategorizim të strukturuar të pagesave për strehimin familjar të bazuar në moshë, në nevojat e fëmijëve bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar, dhe në nevojat e veçanta që fëmijët mund të kenë në varësi të llojit dhe/ose shkallës së aftësisë së kufizuar ose cënueshmërisë. Për

këto arsye, ekziston nevoja për të rritur dhe kategorizuar shumat e pagesës për familjet strehuese bazuar në moshën, kategoritë dhe nevojat e fëmijëve. Kjo gjithashtu do të shërbejë për të fuqizuar shërbimin e kujdesit të strehimit familjar duke i ruajtur familjet strehuese në kuadër të sistemit të kujdesit alternativ. Gjithashtu, rekomandohet që të kategorizohen familjet strehuese për kategori të ndryshme fëmijësh. Në këtë mënyrë do të sigurohej vazhdimi i ndërtimit të kapaciteteve për familjet strehuese në bazë të kategorizimit të tyre me qëllim që të garantohet kujdes i duhur për rastet specifike të fëmijëve në strehim familjar.

Përveç kësaj rekomandohet që shteti të sigurojë vazhdimin e pagesës për këto familje edhe gjatë muajve kur ata nuk kanë fëmijë të strehuar, në shumë më të vogël (për shembull 50% të shumës së rregullt mujore).

Familjet strehuese nuk realizojnë ndonjë përfitim social ose shëndetësor nga pozicioni i tyre por shpesh përdorin burimet familjare për të përmbushur kujdestarinë e tyre, gjë e cila rrezikon stabilitetin e skemës. Rekomandohet që Kosova t'u ofrojë familjeve strehuese përfitime sociale ose shëndetësore për të ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve të tyre që lidhen me kujdesin e një fëmije të strehuar. Rekomandim tjetër do të ishte përfshirja e strehimit familjar si një profesion i njohur brenda skemës tatimore dhe pensionale.


Duke pasur parasysh kursimet financiare që i atribuohen strehimit familjar (strehimi familjar është pesë herë më pak i kushtueshëm krahasuar me kujdesin rezidencial)²⁹, rekomandohet që Kosova të investojë fuqishëm në shërbimet e strehimit familjar duke mundësuar trajnime të mëtejshme për prindërit strehues, përfitime shëndetësore dhe sociale për t'i ndihmuar në menaxhimin e kostove për secilën familje strehuese.

Adoptimi

Në situata kur shteti merr të drejtën prindërore, KDF vendos të drejtën e fëmijës për të jetuar në një mjedis të sigurtë familjar. Adoptimi i mundëson fëmijës pa kujdes prindëror, të drejtën për të jetuar në mjedis të sigurtë familjar. Në Kosovë, Ligji për Familjen³⁰ në detaje i rregullon të gjitha procedurat e adoptimit.

Në kategorinë e adoptimit, Kosova ka arritur rezultatin total 0,614 nga pikët maksimale të mundshme prej 1.0. Rezultatet e Kosovës janë relativisht të larta në ligje dhe politika (0,716) dhe në shërbime (0,807). Përsëri, koordinimi i Kosovës është mirë i pozicionuar me 0,708, mirëpo kapaciteti dhe llogaridhënia e saj janë më të ulëta, me respektivisht 0,521 dhe 0,291

Procedurat ligjore të adoptimit në Kosovë nuk përfshijnë kërkesat për “interesin më të mirë të fëmijës” gjatë gjithë procesit. Ligji për Familjen, në mënyrë të veçantë neni 163 – Lejueshmëria e Adoptimit, shprehimisht thotë se: Personi i cili është kyçur në veprime të paligjshme, ose në veprime që janë në kundërshtim me moralin, në marrjen ose prurjen e fëmijës për qëllim të adoptimit apo i cili e ka autorizuar ose i ka dhënë shpërblim personit të tretë për ta bërë këtë, mund vetëm ta adoptojë fëmijën nëse kjo është e domosdoshme për mirërritjen e fëmijës. [Prandaj, rekomandohet ndryshimi i Ligjit për Familjen për të ndaluar adoptimin e fëmijëve nga personat që kanë qenë të përfshirë në akte të paligjshme gjatë marrjes ose sjelljes së një fëmije për qëllime adoptimi.](#)



Kosova e ndalon adoptimin privat, duke kërkuar kështu përfshirjen e QPS-së, Panelit për adoptim që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe shqyrtimin juridik³¹.

Në procedurën e adoptimit, QPS³² luan një rol kyç në realizimin e kësaj forme të mbrojtjes. Personat e interesuar për adoptimin e një fëmije pa kujdes prindëror duhet të paraqesin kërkesën në gjykatë. Gjykata ka të drejtë të mbledhë të dhëna dhe dëshmi të tjera nga Autoriteti i Kujdestarisë, nga shërbimet sociale dhe ekspertët të tjerë në fushën e kujdesit ndaj fëmijëve për kushtet e adoptimit³³. Megjithatë, gjykata ja përcjell kërkesën QPS-së për të dhënë vlerësimin e saj profesional për familjen. Prandaj, QPS kryen të gjitha veprimet, duke përfshirë: përgatitjen e dosjes për adoptim pas zgjidhjes së statusit ligjor të fëmijës, kryerjen e procedurave për vlerësimin e përshtatshmërisë së prindërve adoptues përmes intervistave me prindërit e mundshëm, trajnimin e familjeve të mundshme birësuese etj. Në praktikë, proceset e adoptimit shpesh vonohen për shkak të procedurave administrative të zhvilluara nga QPS³⁴. [Për shkak se statusi i fëmijës, prindërve biologjikë dhe atyre adoptues është i pa definuar gjatë procesit të adoptimit, rekomandohet që Kosova të kufizojë vonesat e panevojshme në mënyrë që statusi i fëmijëve të zgjidhet më shpejt. Rekomandohet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale vazhdimisht të monitorojë dhe inspektojë QPS-të gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve të braktisur, në mënyrë që fëmijët të largohen nga mjediset e tyre të përkohshme sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të zgjidhet statusi i tyre.](#)

Nga ajo që raportohet, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët më të rritur ose fëmijët me probleme shëndetësore pësojnë nga vonesat në procesin e adoptimit për shkak të interesimit të kufizuar nga familjet potenciale³⁵. [Rekomandohet që Kosova, si mënyrë për të rritur numrin e adoptimeve, të rrisë vetëdijësimin e anëtarëve të caktuar të publikut për nevojat dhe diskriminimin me të cilin përballen fëmijët që presin për adoptim.](#)

Vonesa ka edhe në adoptim pasi që autoritetet publike të ngarkuara për të proceduar adoptimet, nuk janë në gjendje të përmbushin afatet dhe zgjidhur çështjet që dalin. [Rekomandohet që shteti të ofrojë ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e ngarkuar me detyrë në procesin e adoptimit.](#)

Shërbime të specializuara për adoptimin e fëmijëve nuk ka. Ky shërbim është gjithashtu pjesë e mandatit dhe përgjegjësi të Qendrës për Punë Sociale. Sipas Ligjit për Familjen³⁶, gjykatat duhet të punojnë në përgatitjen e familjes adoptuese për proceset e mëtejshme, por kjo jo domosdoshmërisht përfshin këshillimin profesional. Sipas standardeve minimale për shërbimin e adoptimit, për prindërit adoptues duhet të organizohen trajnime, por deri më tani një gjë e tillë nuk ka ndodhur. [Rekomandohet ndërtimi dhe zhvillimi i shërbimit të specializuar për adoptimin e fëmijëve, duke përfshirë ofrimin e këshillimeve profesionale nga QPS si dhe hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit për prindërit potencial adoptues.](#)

Shërbimet e adoptimit që ofrohen nga shteti nuk janë të licencuara ndërsa punëtorët e caktuar marrin një licencë standarde për shërbimet sociale dhe familjare. [Rekomandohet që MPMS të nxjerrë një udhëzim administrativ i cili parasheh procedurat dhe kriteret për licencimin e shërbimeve të ofruara nga autoritetet shtetërore.](#)

Cilësia e shërbimeve të adoptimit të ofruara nga institucionet qeveritare nuk i nënshtrohet monitorimit dhe vlerësimit të jashtëm të siguruar nga autoritetet shtetërore, por i nënshtrohen Njesisë së Monitorimit dhe Inspektimit e cila është një organ i brendshëm në kuadër të MPMS. [Rekomandohet të krijohet një njësi e pavarur e monitorimit dhe inspektimit të jashtëm, për të siguruar cilësinë e shërbimeve të ofruara.](#)

E fundit por absolutisht jo më pak e rëndësishme, llogaridhënia për vendimmarrje në rastet e adoptimeve kërkon kohë të mjaftueshme me periudhat provuese që përfshijnë vizita në shtëpi. Megjithatë, pas periudhës së provës monitorimi i vazhdueshëm nuk kërkohet më³⁷. [Për këtë arsye, rekomandohet që Kosova, për të siguruar një ambient të qëndrueshëm dhe mbrojtës për fëmijën dhe prindërit adoptues, të bëjë monitorim periodik pas përfundimit të periudhës së provës.](#)


Fëmijët që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë

Neni 20 i KDF kërkon që Shtetet Palë, në përputhje me ligjet e tyre nacionale, të sigurojnë kujdes alternativ për fëmijët që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë.

Indeksi ka matur dhe krahasuar pesë dimensionet e veprimeve të qeverisë, për të mbrojtur dhe siguruar kujdesin për fëmijët e pastrehë dhe fëmijët që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë: politikat, shërbimet, kapacitetet, koordinimin dhe llogaridhënien.

Rezultatet e Kosovës për veprimet e përgjithshme të saj për mbrojtjen e fëmijëve që punojnë në rrugë janë 0,158 nga totali i mundshëm prej 1.0. Ky rezultat deri më tani përbën rezultatin më të ulët që Kosova ka arritur në mesin e të gjitha fushave/kategorive të tjera të matura nga Indeksi 2.0. Kjo do të thotë se Kosova si shtet nuk po e trajton fare çështjen e fëmijëve që punojnë në rrugë dhe në të njëjtën kohë nuk po ndërmerr asnjë iniciativë dhe/ose nuk po ndërhyr në nivel të politikave dhe shërbimeve për të mbrojtur këta fëmijë.

Rezultatet e Kosovës në fushën e ligjeve dhe politikave janë po ashtu shumë të ulëta (0,460). Rezultatet e saj në fushën e shërbimeve janë edhe më të ulëta (0,100). Rezultatet e Kosovës sa i përket koordinimit, deri diku janë më të larta se sa dimensionet e tjera, megjithatë me një rezultat mesatar prej 0,666. Rezultatet e saj për kapacitetin dhe llogaridhënien janë më të ulëta sa i përket kësaj kategorie me 0,044 dhe 0,060, respektivisht.



Programet e Kosovës për parandalimin e varfërisë, siç janë paraparë në Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit³⁸, mund të shërbejnë për parandalimin e daljes së fëmijëve në rrugë për punë ose për strehim. Ligji ofron strehim për familjet ose individët të cilët nuk janë ekonomikisht të qëndrueshëm. Për të ofruar strehim për ata në nevojë, shtatëmbëdhjetë komuna kanë themeluar komitetet përkatëse. Numri i kërkesave nga qytetarët e pastrehë është mjaft i lartë dhe varion nga 250 deri në 550 kërkesa për komunë³⁹. Megjithatë, buxhetet e komiteteve komunale nuk janë aq të larta sa për të përmbushur kërkesat për të drejtat e strehimit. **Komunat, me ndihmën e qeverisë, duhet të ndajnë më shumë fonde për programet lokale të strehimit social, për të garantuar se po kujdesen për të gjitha familjet dhe individët që kanë nevojë për strehim.**

Sa i përket fëmijëve që punojnë në rrugë, ligji aktual nuk përcakton ndonjë shërbim të veçantë që shteti duhet të ofrojë për të adresuar këtë grup të cënueshëm të fëmijëve; duke përfshirë qendrat e kujdesit ditor, strehimoret e natës, shërbimet mobile si dhe shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrit (duke përfshirë mbështetjen sociale, arsimore dhe psikologjike për fëmijët dhe familjet e tyre). Nuk ka standarde financiare të caktuara për të adresuar këto shërbime të veçanta. Rrjedhimisht, Kosova ka kufizuar zbatimin e çdo shërbimi të caktuar për adresimin e çështjes së fëmijëve që punojnë në rrugë, duke shënuar rezultat prej vetëm 0,088 pikë. Rezultati tregon se ka një qasje pothuajse zero proaktive nga institucionet relevante për të arritur te këta fëmijë dhe për t'u ofruar mbrojtje atyre. **Themelimi dhe zhvillimi i shërbimeve bazë për këtë kategori të fëmijëve është një masë e menjëhershme që qeveria duhet të ndërmarrë. Gjithashtu, fuqimisht rekomandohet që Kosova të përfshijë standardet financiare në kuadër**

të kornizës rregullatore për të siguruar buxhetin dhe zbatimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë.

Një shërbim i veçantë duhet të luajë rol primar dhe të domosdoshëm në këtë drejtim: ai i ekipeve mobile. Edhe nëse ekzistojnë shërbime për fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë, është e rëndësishme që së pari të krijohen mekanizma për identifikimin e fëmijëve në këtë gjendje. Ngarkesat aktuale në punë, kapacitetet dhe burimet e punëtorëve socialë në Qendrat për Punë Sociale e parandalojnë një angazhim të tillë të tyre. [Përtej kësaj, ekziston nevojë imediate për themelimin e ekipeve mobile për shërbimet e arritjes të fëmijët në mënyrë që ti identifikojnë, të ofrojnë shërbime për ta, si dhe të krijojnë plane individuale për secilin prej tyre.](#)

Pasi të jenë vendosur mekanizmat e identifikimit, është i nevojshëm krijimi i një baze të të dhënave në nivel nacional për të krijuar një qasje të menaxhimit të rasteve e cila siguron përafrim të duhur me ta. [Kosova duhet të krijojë një bazë të dhënash në nivel nacional me shifra përkatëse të ndara sipas komunave përkatëse, moshës dhe gjinisë. Një bazë e tillë e të dhënave mund të ndihmojë në ndërtimin e të dhënave mbi shkallën e përhapjes dhe të sigurojë që planifikimi buxhetor të ofrojë kontribute të bazuara në nevojën. Ekziston edhe nevoja për të krijuar mekanizma që inkurajojnë regjistrimin e lindjeve në kuadër të këtij grupi të popullsisë.](#)


Përpyekjet e Kosovës lidhur me dimensionin e koordinimit dëshmojnë për ndërtimin e një sistemi për fëmijët që punojnë në rrugë. Komiteti Kombëtar i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve është një organ koordinues në nivel qendror dhe punon për të koordinuar me Komitetet Lokale për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve që gjendet në të gjitha komunat. Këto komitete nuk janë funksionale. [Për këtë arsye rekomandohet fuqizimi i komiteteve lokale dhe krijimi i një mekanizmi efektiv koordinues ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror i cili mundëson që së bashku të hartojnë politikat për veprimet përkatëse.](#)

Bazuar në rezultatet e ulëta të Kosovës në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve që jetojnë dhe/ose punojnë në rrugë, del një rekomandim i përgjithshëm dhe i menjëhershëm për të ndërhyrë dhe përmirësuar këtë gjendje. [Kosova duhet të krijojë një Grant të Veçantë për Shërbimet Sociale në kuadër të granteve të përgjithshme buxhetore për komunat dhe QPS-të për të krijuar shërbime, për t'i zgjeruar ato si dhe për të përmirësuar kapacitetet për ofrimin e shërbimeve cilësore për këta fëmijë.](#)

Mbrojtja e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë

Neni 33 i KDF kërkon që Shtetet Palë të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë masat legislative, administrative, sociale dhe arsimore, për mbrojtjen e fëmijëve nga përdorimi i paligjshëm i narkotikëve dhe substancave psikotrope siç përcaktohet në traktatet relevante ndërkombëtare dhe për parandalimin e përdorimit të fëmijëve në prodhimin e paligjshëm dhe trafikimin e substancave të tilla.

Kosova ka shënuar një rezultat prej 0,396 nga rezultat i mundshëm prej 1.0 në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë. Kosova ka shënuar rezultat nën mesatare në veprimet e saj për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë përmes politikës (0,466). Kosova ka shënuar rezultat mesatar (0,500) në fushën e koordinimit ndërmjet akterëve kryesorë dhe 0,496 në llogaridhënien ndaj përfituesve, familjeve dhe palëve të tjera të interesit. Megjithatë, Kosova ka rezultate dukshëm më të ulëta në ofrimin e shërbimeve për të siguruar mbrojtje dhe reintegrim adekuat për këta fëmijë me 0,250, si dhe në kapacitetin e saj për të ofruar një qasje të duhur për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë me 0,119 pikë.



Për shkak të statusit të saj politik si shtet, Kosova nuk ka ratifikuar ndonjë Konventë Ndërkombëtare mbi abuzimin me narkotikë; megjithatë, korniza ligjore vendore ndalon përdorimin e paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotrope⁴⁰. Sa i përket politikave, shteti nuk jep dënime shtesë për shkeljet me narkotikë të kryera nga të rriturit ku fëmijëve u janë shitur ose kur u janë dhënë narkotikët dhe substancat e tilla. Kodi Penal përcakton moshën minimale prej 16 vjeç për blerjen e alkoolit në të gjitha lokalet, për më tepër, korniza ligjore nuk ndalon shitjen e substancave tretëse fëmijëve, pa autorizimin e duhur nga prindërit ose të rriturit e tjerë⁴¹. Deri më tani, korniza ligjore ka caktuar moshën minimale prej 18 vjeç vetëm për blerjen e duhanit⁴². Si rezultat i kësaj, Kosova ka arritur rezultate të ulëta në veprimet e saj për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi me narkotikë përmes kornizës ligjore dhe politikave me 0,466. **Kosova duhet të parashikojë ndëshkime shtesë në Kodin Penal për shkeljet që kanë të bëjnë me narkotikë të kryera nga të rriturit ku fëmijëve u janë shitur ose u janë dhënë narkotikë. Duhet të përcaktohet moshë minimale 18 vjeç për blerjen e alkoolit në të gjitha ambientet dhe korniza ligjore duhet të parandalojë shitjen e substancave tretëse fëmijëve.**

Kosova nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit fizik për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë; këto shërbime ofrohen në kuadër të shërbimeve të përgjithshme të trajtimit të të rriturve që përdorin narkotikë. Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka krijuar një repart të posaçëm për trajtimin e varësisë por ky repart është i dedikuar për pacientët e rritur, edhe pse ai trajton edhe fëmijët duke qenë se nuk ekziston asnjë objekt tjetër në dispozicion ose repart i veçantë për fëmijët. Psikiatrët dhe mjekët e fëmijëve në spitale nuk kanë kapacitete/trajtime adekuate për t'u marrë me fëmijët që janë viktime të abuzimit me narkotikë dhe nuk kanë burimet e nevojshme (ekipin multidisiplinar, repartet ose klinikat e ndara) për zbatimin e planeve dhe programeve. Kështu që edhe pse ato janë të rregulluara me dokumente të ndryshme⁴³, zbatimi i tyre është i dobët. Prandaj vendqëndrimet nuk u janë përshtatur fëmijëve dhe nuk janë mjedise miqësore apo të sigurta për ta. Si përfundim, në thelb nuk ka shërbime të veçanta për rehabilitimin fizik, psikologjik, dhe reintegrimin social

që mbështetin fëmijët që janë viktimë të abuzimit me narkotikë. [Rekomandohet fuqimisht që qeveria të caktojë prioritet mbrojtjen e fëmijëve viktimë të abuzimit me narkotikë nëpërmjet krijimit, sponsorizimit dhe zhvillimit të shërbimeve në nivel shtetëror që mundësohen nga ofruesit shtetëror dhe privat.](#)

Trajtimi mjekësor bazohet vetëm në programet e detoksifikimit që përdorin barna nga Lista e esenciale e barnave të financuara nga Ministria e Shëndetësisë. Megjithatë kujdesi shëndetësor është i lirë për të gjithë qytetarët dhe opsionet minimale të trajtimit me barna (p.sh. detoksifikimi) ofrohen falas, për shërbimet e detoksifikimit, pacientët duhet të marrin pjesë në pagesë për shërbimin e detoksifikimit. OJQ Labyrinth, është e vetmja OJQ lokale e licencuar nga MSH për të ofruar shërbime rehabilitimi, por këto shërbime nuk sponsorizohen nga shteti dhe kjo OJQ nuk është në gjendje të mbulojë të gjitha nevojat. [Është e rëndësishme që këto shërbime të kenë mbështetjen e duhur nga qeveria dhe komuniteti i donatorëve. Rekomandohet që Kosova të zhvillojë standarde financiare për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të abuzimit me narkotikë.](#)

Shërbimet e reintegrimit social duhet të bien nën përgjegjësinë e QPS-ve, megjithatë Qendrat për Punë Sociale nuk kanë kapacitetet e nevojshme për të mbështetur fëmijët viktimë të abuzimit me narkotikë. Shërbime të veçanta dhe programe reintegrimi për fëmijët viktimë të abuzimit me narkotikë nuk ka. Subjektet shtetërore kanë të drejtë të mbështetin procesin e reintegrimit të fëmijës viktimë e abuzimit me narkotikë, siç është reintegrimi në shkollë për rastet kur ato braktisen. Megjithatë, për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme, ato nuk mund të mbështetin prindërit ose kujdestarët për t'u marrë fizikisht dhe emocionalisht me fëmijët viktimë të abuzimit me narkotikë. [Ekziston nevoja për zhvillimin e programeve të reintegrimit në përgjigje ndaj nevojave në rritje të fëmijëve dhe familjeve të tyre.](#)


Në anën tjetër koordinimi mungon në masë të madhe. Kosova ka themeluar Komitetin e Kosovës për Ndërhyrje në Rastet me Narkotikë por ky komitet nuk funksionon dhe megjithatë janë bërë përpjekje të koordinimit ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale, në veçanti ndërmjet QPS, policisë, drejtësisë dhe arsimit, prapë bashkëpunimi ka mbetur sporadik për situata të tilla pasi shërbimet e ofruara nuk janë specifike dhe janë shumë të kufizuara. [Hapi i ardhshëm do të duhej të përfshinte forcimin e trupit koordinues dhe monitorues ndërmjet ministrive si dhe ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, për të zgjeruar përpjekjet në adresimin e luftës kundër narkotikëve.](#)

Mangësi tjetër e sistemit që kontribuon në rezultate të ulëta të llogaridhënies ka të bëjë me mungesën e informatave të centralizuara dhe mungesën e një baze të të dhënave në nivel kombëtar mbi raportimet e rasteve të fëmijëve viktimë të abuzimit me narkotikë. [Duke shkuar më tej, rekomandohet që Kosova të krijojë mekanizma të qëndrueshëm për grumbullimin e të dhënave dhe të kërkimit në mënyrë që të gjenerojë informata më të qëndrueshme për nivelin e përhapjes së rasteve të abuzimit me narkotikë.](#)

Fëmijët refugjatë, fëmijët që kërkojnë azil dhe fëmijët e përfshirë në konflikte të armatosura

Neni 22 i KDF kërkon që Shtetet Palë të marrin masat e duhura për të siguruar që një fëmijë, i cili kërkon të marrë statusin e refugjatit ose që konsiderohet si i tillë sipas rregullave dhe procedurave të së drejtës ndërkombëtare ose asaj vendore që aplikohet, qoftë vetëm apo i shoqëruar nga prindërit e tij ose nga çdo person tjetër, të përfitojë nga mbrojtja dhe përkrahja humanitare e duhur. Neni 38 i KDF kërkon që Shtetet Palë të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që personat, të cilët nuk kanë mbushur moshën pesëmbëdhjetë vjeç, të mos marrin pjesë drejtpërdrejt në luftëra.

Në këtë kategori Kosova ka shënuar rezultat prej 0,682 pikësh nga gjithsej 1.0, duke qëndruar pak mbi mesataren. Rezultatet e Kosovës sa i përket ligjeve dhe politikave janë 0,788 ndërsa shërbimet e saj regjistrojnë një rezultat prej 0,721. Rezultatet më të ulëta në këtë çështje janë arritur sa i përket koordinimit me 0,666, kapacitetit me 0,500 dhe në fund llogaridhënies me 0,472 pikë.



Për shkak të statusit të saj ndërkombëtar, Kosova nuk e ka ratifikuar Konventën lidhur me Statusin e Refugjatëve, të ndryshuar me Protokollin për Statusin e Refugjatëve, Konventën për Statusin e Personave pa Shtetësi dhe Konventën për Reduktimin e Pashtetësisë, katër Konventat e Gjenevës, Protokollin Shtesë I, Protokollin Shtesë II, Konventën për ndalimin e përdorimit, deponimit, prodhimit dhe transferimit të minave kundërkëmbësorike dhe shkatërrimit të tyre dhe Protokollin Opsional të Konventës për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura. Megjithatë, Kosova, nëpërmjet legjislacionit vendor, ka trajtuar çështjen e fëmijëve si refugjatë, fëmijëve që kërkojnë azil dhe përfshirjes së fëmijëve në konflikte të armatosura, konkretisht përmes Ligjit për Azil⁴⁴ dhe Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës⁴⁵.

Sa i përket përgatitjes për situatat e krizave humanitare, shteti nuk ofron e as nuk sponsorizon programe trajnimi për situata emergjente/ndihma humanitare. **Rekomandohet që shteti të ofrojë ose të sponsorizojë programe trajnimi në mjediset e arsimit, shërbimet e kujdesit rezidencial dhe të komunitetet si mënyrë për t'u përgatitur për çdo rast të tillë, për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe situatat emergjente/ndihmat humanitare.**

Në vitin 2012, Kosova ka krijuar një qendër azili me mbështetjen e BE⁴⁶, e cila i plotëson të gjitha standardet fizike. Megjithatë, Kosova ende nuk i ka kapacitetet e duhura për të mbuluar nevojat e arsimit për fëmijët refugjatë që mund të mbërrijnë në Kosovë nga vende të ndryshme. **Rekomandohet që Kosova të rrisë kapacitetet për të siguruar qasje në arsim i cili njih kulturën, gjuhën dhe nevojën për integrimin social të fëmijëve refugjatë. Rekomandohet gjithashtu që rregullisht të trajnohen autoritetet shtetërore dhe profesionistët përkatës për mbrojtjen e fëmijëve në mënyrë që të rrisin kapacitetet e tyre me rastin e shfaqjes së nevojave të tilla.**

Autoritetet shtetërore ende nuk kanë siguruar ndonjë monitorim dhe vlerësim të jashtëm për shërbimet e ofruara për këta fëmijë nga organet qeveritare ose OJQ-të. Ekzistojnë institucione, organe por edhe organizata që kryejnë monitorim të jashtëm (siç është Avokati i Popullit), por Njësia legjitime e Inspektimit vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. [Rekomandohet të krijohet një mekanizëm i jashtëm monitorimi dhe vlerësimi që do të vlerësonte cilësinë e këtyre shërbimeve.](#)

Tortura dhe çdo trajtim ose dënim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues ndaj fëmijëve

Neni 37 i KDF kërkon që Shtetet Palë të sigurojnë që asnjë fëmijë të mos i nënshtrohet torturës, as trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, që asnjë fëmijë të mos i mohohet liria në mënyrë të paligjshme ose arbitrare dhe që çdo fëmijë i privuar nga liria të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe me respekt.

Në veprimet e saj për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga tortura dhe trajtimet ose dënimet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, Kosova ka arritur rezultat prej 0,640 pikësh nga maksimumi i mundshëm prej 1.0. Kjo do të thotë që përpjekjet e Kosovës për të mbrojtur djemtë dhe vajzat nga çdo formë e trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues duhet të rriten edhe më tej në mënyrë që të garantohet që fëmijët të trajtohen me dinjitet siç kërkon KDF.

Në politikat e saj për parandalimin e torturës, Kosova ka arritur rezultat prej 0,808 pikë, në ofrimin e shërbimeve rezultatet janë 0,630, në kapacitetet e saj për parandalimin e torturës rezultatet janë 0,424 pikë, në mekanizmat për llogaridhënie rezultatet janë 0,404 dhe në koordinimin mes palëve të interesit për t'u përgjigjur nevojave, rezultatet janë 0,104.


Për shkak të statusit të saj ndërkombëtar, Kosova ende nuk e ka ratifikuar Konventën kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues dhe Protokollin Opsional të Konventës Kundër Torturës. Megjithatë, Kosova ka rregulluar çështjet e mësipërme në kuadër të legjislacionit të brendshëm, veçanërisht nëpërmjet Kodit të Drejtësisë për të Mitur⁴⁷.

Rekomandohen ndryshime shtesë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, për të përfshirë shkurtimin e paraburgimit për rastet me fëmijë, në gjashtë muaj.

Zbatimi i Kodit të Drejtësisë për të Mitur i Kosovës është i kufizuar. Një raport i kohëve të fundit i monitorimit të Qendrës Korrektuese për të Miturit në Lipjan, të kryer nga KOMF, tregon se të miturit në Qendër kanë pohuar përdorimin e masave disiplinore të papërshtatshme, duke përfshirë edhe ndëshkimin fizik⁴⁸. **Rekomandohet që Kosova të bëjë hetim të pavarur për këtë Qendër për të gjetur nëse masa të papërshtatshme disiplinore janë përdorur ndaj të miturve.**

Ekziston gjithashtu nevoja për të ndarë fëmijët dhe të rriturit në të gjitha objektet e kujdesit institucional duke përfshirë edhe institucionet korrektuese. Aktualisht, ka vajza dhe gra të cilat mbahen në të njëjtin objekt dhe pavion⁴⁹. **Rekomandohet që Ministria e Drejtësisë të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të ndarë fëmijët dhe të rriturit në të gjitha objektet institucionale, duke përfshirë edhe ato korrektuese për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për rehabilitimin dhe procesin e reintegrimit.**

Në përputhje me Kodin e Drejtësisë për të Mitur të Kosovës i cili kërkon që të merren masa edukative ndaj të miturve në situatë të dhënies së dënimit dhe që vendqëndrimet e tyre të jenë gjysëm të mbyllura në vend të atyre plotësisht të mbyllura, duhet të punohet edhe më tej për ta zbatuar plotësisht një gjë



të tillë⁵⁰. Kosova ka ndërmarrë veprime për të garantuar masat edukative për të miturit e dënuar dhe tani janë të nevojshme hapat e mëtejshëm për t'ju përmbajtur plotësisht kërkesave të ligjit. [Rekomandohet që Kosova të krijojë një tip institucioni të hapur dhe gjysmë të mbyllur, për të miturit nën masa edukative.](#)

Për të ofruar llogaridhënien e nevojshme në sigurimin e trajtimit të të miturve të mbajtur në institucion dhe sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur të Kosovës, gjyqtarët duhet të vizitojnë Qendrën Korrektuese ku të miturit mbahen, çdo gjashtë muaj për të ndjekur dhe vlerësuar efektet e masave arsimore, duke dhënë rekomandime të mëtejshme për mirëqenien e çdo të burgosuri. Për momentin, kjo dispozitë nuk është respektuar plotësisht nga gjyqtarët⁵¹. [Rekomandohen gjyqtarët që të respektojnë dispozitat ligjore dhe të ndërmarrin vizita të rregullta në terren me qëllim të krijimit të llogaridhënies së nevojshme për procesin e trajtimit dhe reintegrimit të çdo të mituri.](#)

Për shkak se drejtësia për të mitur mbështetet në rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve për të kufizuar ritmet e recidivizmit, ekziston nevoja për të fuqizuar programet individuale dhe angazhimin e shpeshtë të profesionistëve të nevojshëm. Të miturit që mbahen në Qendrën Korrektuese ende nuk kanë një program individual të përgatitur nga punëtorët social dhe psikologët për t'ju përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të tyre⁵². Momentalisht ekzistojnë vetëm dy punëtorë social dhe një psikolog për stafin në Qendrën Korrektuese krahasuar me 135 zyrtarë korrektues që janë të angazhuar në objekt⁵³. [Rekomandohet që Kosova të rrisë numrin e personelit profesional të kualifikuar për të punuar me të mitur dhe të rrisë kapacitetet e tyre në zhvillimin e programeve individuale arsimore për rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve.](#)

Rehabilitimi përmes edukimit është gjithashtu element i rëndësishëm për rehabilitimin e të miturve nga delinkuenca. Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës cakton raportin e një edukatori me më së shumti 20 të mitur të mbajtur në institucion⁵⁴. Momentalisht nuk ka asnjë edukator në Qendrën Korrektuese. Sidoqoftë, numri prej 20 të miturish është shumë i lartë për një edukator që të përballlet më ta dhe t'i udhëzojë përmes procesit të edukimit dhe rehabilitimit. [Rekomandohet që gjatë ndryshimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, të zvogëlohet numri prej 20 të miturve në maksimum 10 të mitur në një grup me një edukator⁵⁵.](#)

Sistemi edukativ për momentin bëhet në kuadër të objekteve të Qendrës Korrektuese që paraqet shkelje të KDM⁵⁶. [Rekomandohet që Kosova t'u mundësojë qasje të miturve në sistemin e rregullt arsimor jashtë Qendrës Korrektuese ashtu si kërkohet nga ana e Kodit për Drejtësi për të Mitur.](#)


Për nevoja të llogaridhënies, Qendra Korrektuese ende nuk ka mekanizma efikas për ankesa përmes së cilave do të dëgjoheshin shqetësimet e të ndaluarve. Meqë Zëvendës Drejtori i Qendrës Korrektuese menaxhon kutinë e ankesave dhe vetë objektin, ekziston një efekt distancues në raportimin e ankesave⁵⁷. [Rekomandohet që institucioni të krijojë një mekanizëm të jashtëm për ankesa për të rritur besimin në mesin e të miturve, për të fuqizuar të drejtën e të miturve që t'i mbajnë përgjegjës zyrtarët dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre.](#)

Administrimi i drejtësisë për të mitur

Neni 40 i KDF kërkon që Shtetet Palë t'i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në reintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

Në kategorinë e administrimit të drejtësisë për të mitur, Kosova ka arritur rezultatin më të lartë (0,844) në krahasim me të gjitha fushat e tjera që ka matur Indeksi i Mbrojtjes së Fëmijës 2.0. Ngjashëm me këtë, në fushën e politikave, Kosova ka shënuar rezultat maksimal prej 1.0, që do të thotë se përpjekjet e qeverisë për të krijuar legjislacionin adekuat lidhur me drejtësinë për të mitur në nivelin e politikave janë priorizuar dukshëm. Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Kodi i Procedurës Penale konsiderohen të jenë ndër më të mirat në rajon.

Kosova ka shënuar rezultat prej 0,747 pikë në zbatim, që është rezultati më i lartë nga gjithë rezultatet e tjera të zbatimit, për të gjitha kategoritë e matura. Kosova ka arritur rezultat prej 0,884 pikë në komponentin e shërbimeve dhe 0,770 pikë në nivelin e llogaridhënies. Megjithatë, ekziston një ndryshim i madh me rezultatet në fushën e kapacitetit me 0,500 pikë dhe në nivel të koordinimit me 0,500 pikë.



Në situatat e drejtësisë penale, ligji e kufizon ndalimin si mjet "i fundit"⁵⁸ dhe përcakton kohën e shërbimit në raport me seriozitetin e veprës. Meqë paraburgimi mund të shndërrohet në një formë dhune, në rastin e fëmijëve, është e rëndësishme që Kosova të shkojë më larg; **korniza ligjore duhet të rishikohet për të akomoduar rekomandimet e Komitetit të OKB për të Drejtat e Fëmijës të cilat, në rastin e fëmijëve, e reduktojnë paraburgimin në gjashtë muaj.**

Kosova fuqishëm zbaton masa të ndryshme dhe alternative për të miturit. Në vitin 2016, Shërbimi Sprovues i Kosovës ka përpunuar 1157 raste me të mitur, ku 686 prej të miturve kanë pasur nevojë për masa të diversitetit⁵⁹. Në vend të burgimit pas dhënies së dënimit, Kosova ka vendosur masa alternative siç janë urdhëri për mbikëqyrje nga prindërit, autoriteti i kujdestarisë, rekuperimi/dëmshpërblimi i viktimave, këshillimi, shërbimi sprovues, arsimit dhe kurse të aftësisë profesionale. **Rekomandohet që të avancohen më tej masat edukative për këshillim të të miturve si shërbim i cili shkon përtej rehabilitimit dhe reintegrimit duke kufizuar kështu rastet e recidivizmit.**


Megjithatë, rezultatet e indeksit tregojnë se koordinimi ndërmjet të gjitha agjencive të ndryshme dhe çështjeve lidhur me administratën e drejtësisë për të mitur në nivel qendror (kombëtar) ka nevojë për përmirësim. Në nivel komunal ekzistojnë panele të specializuara për administrimin e rasteve për fëmijët dhe përcjelljen e mëtejshme të rasteve të tyre mirëpo, koordinimi ndërmjet institucioneve ende nuk është tërësisht efektiv. Ka përpjekje për koordinim (për shembull për mbikëqyrje nga organet e kujdestarisë, për ndjekjen e rregullt të shkollimit, për kurse profesionale ose shërbime nga OJQ-të). Megjithatë, edhe më tej evidentohen vështirësi në koordinim mes organeve institucionale, shkollave dhe shërbimit sprovues⁶⁰. Shkollat hezitojnë të koordinohen me shërbimin sprovues. **Rekomandohet që të aktivizohet Këshilli për Mbrojtjen dhe**

Drejtësinë për Fëmijët, i cili nuk është më në funksion dhe ka nevojë për një rifillim të punës dhe angazhim në koordinim të plotë mes aktorëve.

Gjithashtu, ekzistojnë vonesa të gjata midis aktakuzave fillestare dhe vendimit për rastet. Me një vonesë trevjeçare të regjistruar në procedurat për të miturit për shkak të ngarkesës së madhe të gjykatave, rezultatet mund të kenë pasoja për rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve duke patur parasysh nevojën për të ndikuar në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve gjatë këtyre viteve vendimtare⁶¹. [Rekomandohet që Kosova të caktojë prioritetet për shqyrtimin gjyqësor të rasteve që kanë të bëjnë me të mitur në mënyrë që kjo t'i shërbejë interesit më të mirë të fëmijëve.](#)

Rezultatet e ulëta të Kosovës në fushën e kapaciteteve janë pasojë e kapaciteteve të kufizuara në zbatimin e dispozitave për: urdhrat e supervizimit dhe të mbikëqyrjes, trajtimin në shëndet mendor, dëmshpërblimin/rekuperimin e viktimave, këshillimin, shërbimin sprovues, arsimin, aftësimin profesional dhe punën në komunitet. Edhe pse Kodi i Drejtësisë për të Mitur kujdeset për këtë kategori, ja vlen të theksohet se aktualisht nuk ka familje strehuese të themeluara për të siguruar kujdesin e duhur për fëmijët që janë në konflikt me ligjin. [Rekomandohet që Kosova të ndërtojë kapacitetet e saj për ngritjen e cilësisë në zbatimin e masave të diversitetit.](#)

Përfundimet mbi politikat



[Ligjet dhe politikat]

Neni 4 i KDF kërkon që "Shtet Palë të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme legjislative, administrative dhe masat e tjera për zbatim të të drejtave të njohura në Konventën aktuale...". Ideja e KDF nuk është të mbetet dokument i idealeve mirëpo një dokument i cili përshkruan zbatimin.

Kosova ka arritur rezultatin 0,508 nga ai i mundshëm prej 1.0 për zbatimin e zotimeve të KDF. Politikat dhe legjislacioni shënojnë rezultatin 0,762 ndërsa boshllëku mes legjislacionit dhe zbatimit të tij është 0,254.

Hapat e ardhshëm duhet të përfshijnë rritjen e investimeve financiare për ndërtim të kapacitetit adekuat në mënyrë që të përmyllet boshllëku mes politikave dhe zbatimit. Indeksi ofron rekomandimet në linjë me pesë dimensionet e veprimit të Geverisë: politikat, shërbimet, kapacitetet, koordinimin, llogaridhënien.

Është një nevojë urgjente për ndryshimin e Kodit Penal për të parandaluar që personat e dënuar për vepra të dhunshme dhe abuzime seksuale të fëmijëve të punojnë më këta të fundit. Ligjet e Kosovës duhet të kërkojnë edhe kontrollin e historikut penal për të gjithë personat që punojnë me fëmijë dhe/apo janë në kontakt me ta. [Rekomandohet ashpërsimi i dënimeve për trafikimin me fëmijë.](#)

Ligji për Familjen, në mënyrë të veçantë neni 163 – Lejueshmëria e Adoptimit, shprehimisht thotë se: Personi i cili është kyçur në veprime të paligjshme, ose në veprime që janë në kundërshtim me moralin, në marrjen ose prurjen e fëmijës për qëllim të adoptimit apo i cili e ka autorizuar ose i ka dhënë shpërblim personit të tretë për ta bërë këtë, mund vetëm ta adoptojë fëmijën nëse kjo është e domosdoshme për mirërritjen e fëmijës. [Prandaj, rekomandohet ndryshimi i Ligjit për Familjen për të ndaluar adoptimin e fëmijëve nga personat që kanë qenë të përfshirë në akte të paligjshme gjatë marrjes ose sjelljes së një fëmije për qëllime adoptimi.](#)

Rekomandohet që Kosova të ndryshojë Ligjin për Mbështetjen Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara me qëllim të sigurimit të mbrojtjes gjithëpërfshirëse për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara të pjesshme. Ky ligj konsiderohet një ligj diskriminues për fëmijët me aftësi të kufizuara, pasi nje të drejtën për kompensim material vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme dhe nuk përfshin fëmijët me aftësi të kufizuara të pjesshme.

Rekomandohen ndryshime të mëtejshme të Kodit të Drejtësisë për të Mitur duke përfshirë reduktimin e paraburgimit deri në maksimum gjashtë muaj në rastin e të miturve.

[Shërbimet]

Është e nevojshme të sigurohet qëndrueshmëria e shërbimeve të ofruara nga sektori publik dhe ai i OJQ-ve për fëmijët viktime të dhunës, shfrytëzimit dhe trafikimit. Aktualisht, shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrimit ofrohen nga OJQ të cilat janë kontraktuar nga MPMS. Megjithatë, mbështetja financiare e ofruar nga shteti nuk është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat dhe nga ana tjetër,

për shkak të procedurave burokratike, ka mangësi në mbështetjen financiare të ofruar nga MPMS dhe komunat ndaj këtyre ofruesve të shërbimeve. Në përgjigje të numrit të fëmijëve që kanë nevojë për kujdes dhe shërbime dhe për shkak të mungesës së përkrahjes së vazhdueshme, këto strehimore dhe qendrat e kujdesit ditor të menaxhuara nga OJQ po përballen me pasiguri ekzistenciale për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë financiare dhe po rrezikojnë mbylljen e tyre. Fëmijët që përfitojnë nga këto shërbime janë të detyruar të lëvizin nga një formë e kujdesit në një formë tjetër gjë e cila përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të fëmijës, sepse ka një ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik dhe psikologjik. Për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve sociale për fëmijët e cënueshëm, duhet që shuma e buxhetit të alokuar për të financuar shërbimet sociale, të rritet nga MPMS. Komunat brenda buxhetit të tyre duhet të garantojnë alokimin e buxhetit për shërbimet sociale. Buxheti duhet të bazohet në nevojat e fëmijëve në kuadër të secilës komunë.

Rekomandohet që Kosova të sponsorizojë shërbimet sociale me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Themelimi i qendrave të kujdesit ditor është një nevojë e madhe; për trajtim, rehabilitim dhe reintegrim të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Rekomandohet që Kosova të krijojë shërbime për mbrojtjen e fëmijëve që punojnë në rrugë, si qendrat ditore, strehimoret e natës, shërbimet në terren dhe ekipet mobile si dhe shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrimit (duke përfshirë mbështetjen sociale, arsimore dhe psikologjike për fëmijët dhe familjet e tyre).

Fuqimisht rekomandohet që qeveria të caktojë si prioritet mbrojtjen e fëmijëve që janë viktima të abuzimit me narkotikë; ajo duhet të krijojë ose të sponsorizojë shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrimit.

Hapja e një linje të re telefonike pa pagesë, të dizajnuar me dhe për fëmijët. Shërbimi duhet të pranojë telefonatat dhe të ofrojë mbështetje, këshillim dhe krijim të rrjetit për fëmijët në situata të dhunës, abuzimit, neglizhimit, abuzimit me substanca narkotike, rrëmbimit, trafikimit dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

[Kapaciteti]

Sigurimi i financimit të qëndrueshëm dhe adekuat për shërbimet sociale në Kosovë përmes ndryshimit të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe krijimin e një Granti Specifik për Shërbime Sociale. Ky grant duhet të ketë kriteret të qarta për të siguruar formulë të drejtë dhe adekuate të financimit për shërbimet sociale.

Krijimi i Grantit për Shërbimet Sociale bazuar në njërin nga dy alternativat e propozuara nga KOMF. Të sigurohet se të drejtat e mirëqenies dhe ofrimi i shërbimeve bashkëkohore rekomandohen për LFPL në njërin nga alternativat e mëposhtme:

Alternativa I: Grant specifik për shërbimet sociale i llojit të mbyllur, është alternativë më adekuate për ofrimin e një minimumi të sigurt të shërbimeve sociale;

Alternativa II: Të bëhet ndarja e dedikuar për shërbime sociale në përqindje brenda grantit të përgjithshëm. KOMF bën me dije që alternativa e dytë nuk garanton siguri financiare në masë sikurse alternativa e parë.

Miratimi i standardeve financiare për mbështetje të duhur të shërbimeve dhe në harmoni me standardet e cilësisë. Pa vendosjen e standardeve financiare është e vështirë të sigurohen buxhete të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për shërbimet.

[Llogaridhënia]

Krijimi i mekanizmave të jashtëm dhe të pavarur të inspektimit për të vlerësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe administrimin e licencimit.

Inspektimi duhet të vlerësojë të dy shërbimet, ato private dhe ato të sektorit publik (QPS). Përfundimet e Indeksit 2.0 paraqesin rezultate të dobëta të llogaridhënies në të gjitha fushat. Rezultatet varen pjesërisht nga prezenca e mekanizmave të brendshëm të inspektimit që kryhen nga njësitë që veprojnë brenda ministrive. Brenda njërive inspektuese ekzistuese ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe financiare për të bërë vizita efektive në terren, përkatësisht për të mbuluar gjithë territorin e Kosovës. Fuqishëm rekomandohet të bëhen investime në krijimin dhe forcimin e mekanizmave të jashtëm dhe të pavarur të inspektimit me kapacitetet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të kërkuara.

Duhet të zbatohet procesi i licencimit të detyrueshëm për shërbimet publike të ofruara nga QPS ose autoritetet e tjera publike.

Aktualisht, individët/profesionistët si ofruesit privat të shërbimeve/OJQ detyrohen të marrin licencën, por ofruesve të shtetit ende nuk u kërkohet të marrin licencën për shërbimet. Rekomandohet që MPMS të nxjerrë një Udhëzim Administrativ për Licencimin e Shërbimeve Shtetërore që përputhen me standardet minimale për shërbimet sociale. Licencimi do të siguronte llogaridhënie dhe monitorim të mëtejshëm të të gjithë ofruesve të shërbimeve publike.

Hulumtimet dhe grumbullimi i të dhënave duhet të konsolidohen për të përcaktuar numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijët e përfshirë në punë dhe fëmijët viktimë të abuzimit me narkotikë. Të dhënat e tilla duhet të ndahen sipas moshës, gjinisë, llojeve të aftësisë së kufizuar dhe sipas komunave.

[Koordinimi]

(Niveli qendror) Operacionalizimi dhe forcimi i mekanizmave të koordinimit në nivel qendror si: Këshilli për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë, Komiteti i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, me qëllim të rritjes së koordinimit të veprimeve ndërmjet palëve të interesuara.

(Niveli lokal) Shkrirja e mekanizmave koordinues për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal, në një mekanizëm. Aktualisht, në nivelin lokal ekzistojnë shumë organe koordinuese që përbëhen nga profesionistë të njëjtë, duke krijuar një mbivendosje, ngarkesë dhe konfuzion të lidhur me shërbimet. Prandaj, rekomandohet shkrirja e këtyre organeve në një mekanizëm, në mënyrë që të sigurohet efikasitet në koordinimin e veprimeve midis aktorëve lokal dhe qendror.

MIRËNJOHJE

Donatori

Kolaicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF dëshiron të falenderojë donatorin – Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë për mbështetjen financiare të projektit “Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë”, përmes së cilit është bërë i mundur ky publikim. KOMF i është mirënjohës për mbështetjen dhe besimin.



Kolaicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF falenderon ChildPact dhe World Vision International për ekspertizën dhe mbështetjen profesionale të ofruar gjatë këtij procesi.

Këshilltari

Jocelyn Penner Hall është Drejtor i Politikave në zyrën e World Vision International për Lindjen e Mesme dhe Evropën Lindore. Jocelyn ka diplomë BA në studime ndërkombëtare dhe ekonomi, JD në fakultetin juridik dhe një diplomë LLM në legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Para se të fillonte punën për World Vision, Jocelyn ka punuar si nëpunës pranë Gjykatës Ndër-Amerikane për të drejta të njeriut në Costa Rica.

Menaxheri i mbledhjes së të dhënave

Andy Guth është një nga specialistët kryesor të mbrojtjes së fëmijëve në rajon, me mbi 26 vite të përvojës në mbrojtje dhe mirëqenie të fëmijëve. Portfolio e tij përfshin punën me OJQ të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, agjenci të Kombeve të Bashkuara dhe Qeveri duke përfshirë Qeveritë e Rumanisë, Bullgarisë, Moldavisë, Ruisë dhe Kroacisë. Duke filluar nga 1997, z. Guth është përfshirë drejtpërdrejtë në dizajnimin e Strategjisë së reformës së mirëqenies së fëmijës në Rumani, Bullgari, Moldavi, Rusi dhe Kroaci.

Autorët

Donjeta Kelmendi është zëvendës Presidente e ChildPact dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF në Kosovë. Donjeta është një juriste dhe ka një përvojë të vërtetshme në mbrojtjen e fëmijëve në nivel kombëtar, në Kosovë. Ajo ka punuar me organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e fëmijëve që nga viti 2006. Ajo ka punuar në organizata të ndryshme si Fondacioni Zviceran Terre des hommes, Hope and Homes for Children dhe të tjerë. Ajo ka punuar si eksperte për WYG International Ltd në procesin e hartimit të standardeve minimale për mbrojtjen e fëmijëve, për herë të parë në Kosovë në vitin 2010.

Klevis Vaqari është Menaxheri e Programit në Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF). Ajo ka mbi 10 vite përvojë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Ka punuar si Drejtore Ekzekutive e OJQ “PEMA” si dhe ka punuar në organizata të ndryshme si Terre des hommes, One to One Children’s Fund dhe Balkan Sunflowers ku ajo është fokusuar në trafikimin e fëmijëve, fëmijët në rrugë, fëmijët e moshës parashkollore dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Znj. Vaqari ka diplomuar për psikologji klinike dhe mban certifikatë post-diplomike

për terapi kognitive dhe të sjelljes.

Blerta Perolli Shehu ka qenë për shumë vite Drejtor i Programit në SOS Fshatrat e Fëmijëve. Znj. Shehu ka punuar në mbrojtje të fëmijëve për 15 vite dhe është profesoreshë për zhvillim të fëmijës. Ajo ka qenë anëtare e Bordit në Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe është kandidatë për PhD në studimet ndërkombëtare për familje dhe komunitet në Universitetin Clemson në SHBA.

Genc Nimoni është Hulumtues kryesor në Organizatën për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet (ÇOHU). Z. Nimoni ka punuar në sundim të ligjit në Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtje të Fëmijëve (KOMF) dhe Ministrinë e Drejtësisë – shërbimi sprovues. Ai ka kryer nivelin MA në drejtimin juridik në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Valbona Çitaku është Drejtoreshë Ekzekutive në OJQ "Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët". Znj. Çitaku është psikologe e trajnuar me 15 vite përvojë pune në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Ajo është anëtare e Bordit për Adoptim dhe Strehim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe është autore e shumë raporteve dhe dokumenteve brenda fushës së saj, duke përfshirë "Standardet Minimale të Kujdesit për Viktimat e Trafikimit".

Armen Mustafa udhëheq Divisionin për Masa Alternative në Shërbimin Sprovues të Kosovës. Z. Mustafa ka ligjruar në Kolegjin AAB dhe ka bërë hulumtime për mbrojtjen e fëmijëve me Koalicionin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF). Ai është kandidat për PhD në psikologji në Universitetin e Tiranës dhe mban diplomën e nivelit master në edukimin gjithëpërfshirës në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin Juvaskula në Finlandë.

Rexhep Gojnovci është Drejtor Ekzekutiv i Organizatës Rinore Akti. Z. Gojnovci përfundoi Fakultetin Juridik dhe punon në fushën e të drejtave të fëmijëve që nga viti 2004. Z. Gojnovci ishte Presidenti i parë i Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në vitin 2010, ndërsa gjatë vitit 2012 - 2015 shërbeu si anëtar i Bordit në KOMF. Z. Gojnovci ka punuar si ekspert i jashtëm në shumë organizata dhe agjenci si Organizata Gjermane GiZ në kuadër të projektit "Fuqizimi dhe Zhvillimi i Rinisë në Kosovë, Amici dei Bambini si ekspert ligjor etj.

Liridona Zogaj mbikëqyr menaxhimin e qendrave të kujdesit ditor PEMA që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Në të kaluarën Liridona shërbeu si përfaqësuese e lartë vendore për One-To-One Children's Fund, një OJQ me seli në Mbretërinë e Bashkuar, duke implementuar projekte të financuara nga BE për fëmijët dhe familjet në nevojë në Kosovë dhe si koordinator në Qendrën e Këshillimit Familjar. Zogaj ka punuar për mbrojtjen e fëmijëve për 10 vjet dhe ka kryer hulumtime dhe analiza të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo është anëtare e Komisionit të MPMS për licencimin e profesionistëve që punojnë në ofrimin e shërbimeve familjare dhe sociale.

Ibadete Krasniqi është Drejtoreshë Ekzekutive e OJQ "Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror". Ajo mban Masterin e Politikave Sociale dhe Mirëqenies së Fëmijëve. Znj. Krasniqi ka 16 vjet eksperiencë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Znj. Krasniqi është anëtare e Komisionit të Licencimit për Shërbimet Sociale pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ajo është autore e shumë raporteve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve brenda organizatës ndërkombëtare Amici dei Bambini. Znj. Krasniqi ka dhënë kontributin e saj në

hartimin e standardeve minimale për kujdestarinë, adoptimin, strehimin familjar dhe strehimin tek të afërmit, etj.

Shukrie Bytyqi punon si Menaxhere e Projektit me OJQ-në lokale PEMA – Qendra e Kujdesit Ditor, në Kosovë. Ajo ka më shumë se pesë vjet përvojë pune në fushën e mbrojtjes së fëmijëve si dhe në mbrojtjen e kategorive të tjera të cënueshme të fëmijëve. Për më shumë se tre vjet, ajo ka punuar drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve për këta fëmijë si këshilluese psikosociale, me fokus në fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e dhunës në familje. Që prej më shumë se një viti ajo punon si menaxhere e projektit në OJQ "PEMA" në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e katër qendrave të kujdesit ditore në Kosovë. Po ashtu, gjatë vitit 2012, znj. Bytyqi ka punuar shkurtimisht në Klinikën Psikiatrike. Përveç diplomimit në psikologjinë klinike ajo mban edhe një diplomë master në psikologjinë klinike dhe mbi 40 seanca trajnimi për mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu ajo është akredituar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si një ofruese e shërbimit social dhe familjar.

Mevlude Murtezi është Drejtoreshë Ekzekutive e organizatës lokale Childproof – CIPOF, e cila punon kryesisht në fushën e arsimit me fokus të veçantë në arsimin parashkollor. Ka një përvojë pune të madhe me fëmijët, ku ka bashkëpunuar me disa organizata që punojnë në fushën e arsimit të fëmijëve. Prej vitit 2010 ajo është udhëheqëse dhe trajnere e programit për Edukimin e Fëmijërisë së Hershme "Majeutika". Z. Murtezi është anëtare e Këshillit të Drejtorëve për institucionet publike parashkollore, në nivel kombëtar. Që nga viti 2000, ajo ka qenë e përfshirë në mënyrë aktive në veprime që synonin të ndihmonin refugjatët dhe në veçanti të lehtësonin reintegrimin e njerëzve të kthyer. Theksi kishte të bëjë me gjithëpërfshirjen në institucionet arsimore publike të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian duke u fokusuar në veçanti në reintegrimin e fëmijëve nga këto komunitete.

Arbnora Kllokoqi është Koordinatorë e Projektit në Koalicinin e OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve. Znj. Kllokoqi ka disa vjet eksperiencë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Ajo është anëtare e një fondacioni zviceran për mbrojtjen e fëmijëve dhe personave në situata të rrezikshme. Ka një diplomë BA në menaxhim nga Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës.

Valdrin Dervishaj ka mbaruar studimet MA dhe aktualisht ndjek studimet e doktoraturës. Për më shumë se tre vjet ai ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në sistemin e drejtësisë përmes organizatave të shoqërisë civile ku ka monitoruar, analizuar dhe publikuar raporte. Z. Dervishaj është ligjërues në kolegjin Universum në Kosovë. Ai ka kontribuar për çështje të tjera të shërbimit publik siç janë qeverisja lokale, sundimi i ligjit dhe arsimit.

Arjeta Balaj ka kryer studimet BA në Biznes. Ajo ka disa vite përvojë pune në kompani dhe biznese private por ka përvojë edhe në sektorin e mirëqenies sociale, me fokus të veçantë në mirëqenien e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Ndër të tjera, znj. Balaj është angazhuar nga UNICEF si udhëheqëse/mbikëqyrëse e ekipit gjatë procesit të hulumtimit dhe mbledhjes së të dhënave nga Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) të kryer nga UNICEF.

Vizualizimi dhe Dizajnimi
i të dhënave

ASHA

Fotografia

Silviu Ghetie
Granit Kallaba

Shtojcë – Metodologjia e Indeksit

Korniza e Indeksit

Korniza e Indeksit përfshin serinë e 987 indikatorëve të cilët së bashku masin politikën e shtetit dhe veprimet drejt mbrojtjes së fëmijës. Indikatorët janë nxjerrë nga gjashtë burime.

Grupi i parë i indikatorëve vjen nga të dhënat statistikore për statusin aktual të mbrojtjes së fëmijëve të vajzave dhe djemve në secilin vend. Për shembull, një indikator merr parasysh shkallën e fëmijëve të moshës 0-2 vjeç në kujdesin rezidencial (për 100,000 banorë të moshës 0-2 vjeçare) në fund të vitit. Për shqyrtim të të gjithë treguesve kuantitativ të përdorur, ju lutemi shihni seksionin shtesë të indikatorëve të këtij informacioni. Të dhënat e mbledhura për këtë seksion kanë origjinën direkt nga baza e të dhënave TransMoEE të UNICEF-it, një burim i të dhënave i përdorur gjerësisht për mirëqenien e fëmijëve në nivel global dhe të dhënat zyrtare statistikore të raportuara nga vendi.

Grupi i dytë i indikatorëve vjen nga Neni 4 i KDF. Ky Nen kërkon që shtetet të aplikojnë të gjitha masat e përshtatshme brenda mandatit të Qeverisë për të arritur mbrojtjen e fëmijëve. Indeksi i referohet kësaj kategorie si “mjedisi i qeverisjes” për mbrojtje të fëmijëve. Një shembull i indikatorit të mjedisit të qeverisjes është: A është aprovuar ligji i konsoliduar për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve?

Grupi i tretë i indikatorëve bazohet në nenin 2 të KDF. Ky nen kërkon që Shtetet Palë të angazhohen që të respektojnë të drejtat e garantuara në këtë Konventë dhe t’ja garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj diskriminimi dhe të marrin të gjitha masat e duhura për të plotësuar këtë kërkesë.

Grupi i katërt i indikatorëve bazohet në nenin 7 të KDF. Ky nen kërkon që fëmijët të regjistrohen menjëherë sapo të lindin dhe qysh atëherë kanë të drejtën të kenë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre. Neni 7 kërkon që Shtetet Palë të sigurojnë zbatimin e këtyre të drejtave. Regjistrimi i lindjeve konsiderohet të jetë një e drejtë themelore e fëmijës.

Grupi i pestë i indikatorëve përdor nene specifike të mbrojtjes së fëmijëve nga KDF dhe parime nga qasja e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve si bazë e përbashkët dhe matricë për indikatorët kualitativ. Për të shpalosur secilën nga kërkesat e neneve, korniza e Indeksit mbështetet në Doracakun e Implementimit për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve të publikuar nga UNICEF. Doracaku ofron analizë të secilit nen të KDF nga Observimet dhe Përfundimet e Komitetit për të Drejta të Fëmijëve me mbi 300 opinione të ndryshme. Doracaku ofron një seri të përgjigjeve “po”, “jo” dhe “pjesërisht e zbatuar” për të krijuar një lloj të kuptuari të rëndësisë së secilit nen. Indeksi i përdor këto lista kontrolli si indikator thelbësor për kornizën. Indikatorët kualitativ janë pyetjet “po”, “jo” dhe “pjesërisht e zbatuar” të cilat vlerësojnë (i) Politikat/kornizën ligjore dhe atë rregullatore; (ii) Shërbimet, proceset, mekanizmat; (iii) Kapacitetin; (iv) Llogaridhënie; dhe (v) Koordinimin dhe bashkëpunimin e shtetit në lidhje me nenet e KDF për mbrojtjen e fëmijëve. Këto elemente kyçe janë të nevojshme për të arritur sistemin funksional të mbrojtjes së fëmijëve. Nenet e KDF të zgjedhura janë ato të cilat shoqërohen me të drejtat e çdo fëmije që nuk duhet të jetë subjekt i dëmit dhe detyrës së shtetit

për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për fëmijët në rrezik.

Grupi i gjashtë i indikatorëve fokusohet në mënyrë të veçantë në përkrahjen e Qeverisë për punëtorët social. Puna sociale luan rol kyç brenda sektorit publik për të administruar mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve, proceseve dhe shërbimeve në nivel lokal, nacional ose rajonal. Për këtë, për shkak të rëndësisë së madhe, Indeksi përfshin indikatorët specifik për punë sociale.

Grumbullimi dhe validimi i të dhënave

Çdo ekip nacional i të dhënave ka përfshirë 10 ekspertë për mbrojtje të fëmijëve, dy ekspertë financiar dhe dy ekspertë ligjor të përzgjedhur për të fituar ekspertiza të ndryshme. Një trajnim i udhëhequr nga menaxheri i të dhënave të Indeksit (dhe bashkë-autori i kornizës së Indeksit) është mbajtur për ekipin para mbledhjes së të dhënave. Në fazën e parë të mbledhjes së të dhënave grupet e dy ekspertëve kanë grumbulluar të dhëna në mënyrë të pavarur në një nga katër seksionet e indikatorëve (përdorimi i raporteve, studimeve, neneve, të dhënave statistikore etj.) për të validuar një përgjigje "po", "jo" ose "pjesërisht" si përgjigje ndaj secilit indikator të Indeksit. Në këtë mënyrë, dy ekspertët kanë rishikuar të njëjtin indikatorë ndaras. Në rastet kur nuk kishte informata të bazuara në dëshmi, janë marrë parasysh intervistat me partnerë relevant dhe informatat e bazuara në përvojën personale me ekspertizë relevante në atë fushë specifike.

Pas kompletimit të rishikimit dhe validimit individual janë marrë parasysh përgjigjet e siguruara për të njëjtin indikator nga dy ekspertët e ndryshëm dhe janë krahasuar nga Menaxheri i të dhënave të Indeksit. Për përgjigjet që nuk ishin konsistente ndërmjet dy ekspertëve ose që kishin mungesë të validimit të mjaftueshëm, është kërkuar rishikim i mëtejshëm dhe mbledhje e dëshmimeve. Dy ekspertët e kanë caktuar indikatorin e njëjtë prapë në punën grupore të rishikuar dhe kanë diskutuar mbi dëshmitë si dhe kanë kërkuar informata shtesë kur ka pasur nevojë. Përgjigjet e përbashkëta të siguruara nga secili nën-ekip janë rishikuar më tutje nga Menaxheri i të dhënave të Indeksit. Tri deri në katër rishikime gjatë periudhës prej 3 deri në 4 muaj janë dashur për gjithë procesin e rishikimit me qëllim të arritjes së dakordimit përfundimtar për secilin indikator të konsideruar.

Një kontroll i tërthortë përfundimtar i informatave të siguruara në seksionet e ndryshme të kornizës së Indeksit është kryer nga Menaxheri i të dhënave të Indeksit me mbështetjen e ekipit të ekspertëve.

Vlerësimi

Secili indikator kualitativ kërkon një përgjigje "po", "jo" ose "pjesërisht e implementuar"; për të vlerësuar rezultatet, "po" = 1 ; "jo" = 0, dhe "pjesërisht e implementuar" = 0.5. Në situata ku disa nën-indikatorë i kanë kontribuar indikatorit kryesor rezultati përfundimtar kryesor është kalkuluar si një mesatare e pikëve të nën-indikatorëve të vet (p.sh. $1+0,5+0+1+0,5 = 3 : 5 = 0,6$).

Përsa i përket indikatorëve kuantitativ, është aplikuar një formulë lineare e transformimit:

$$Y = X - X_{\min} / X_{\max} - X_{\min}$$

ku Y është rezultati, X janë të dhënat kuantitative për shtetin përkatës, X_{min} janë të dhënat kuantitative në shtetin me performancën më të ulët dhe X_{max} janë të

dhënat kuantitative për shtetin me performancën më të lartë.

Një rezultat mesatar është kalkuluar për pesë nga gjashtë burime të indikatorëve 1) Statusi aktual i mbrojtjes së fëmijës, vajzave dhe djemve 2) Mjedisi i qeverisjes; 3) Regjistrimi i lindjeve; 4) Mos Diskriminimi dhe 5) Puna sociale. Në rastin e burimit kryesor (Nenet e KDF të analizuara me qasjen e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve), secili nen i KDF dhe indikatorët e tij vlerësohen në veçanti (për të krijuar nga një rezultat mesatar për nen). Rezultati përfundimtar (i përgjithshëm) i Indeksit kalkulohet si një mesatare e të gjithë indikatorëve kryesor të përfshirë në kuadër të të gjithë komponenteve të kornizës së Indeksit; në këtë mënyrë, secili indikator kryesor kontribuon në mënyrë të barabartë në rezultatin final (të përgjithshëm) të Indeksit.

SHËNIM

Të dhënat e këtij indeksi nuk janë plotësisht të krahasueshme me Indeksit 1.0, për shkak të komponentëve shtesë të përfshirë (Regjistrimi i lindjeve, Mosdiskriminimi, Fëmijët Refugjatë / ndërhyrja emergjente, Tortura dhe trajtimi degradues, Administrimi i drejtësisë për të mitur). Gjithashtu, për të mbështetur grumbullimin më të saktë të të dhënave, disa indikatorë të përfshirë në Indeksit 1.0 u ndanë në një sërë treguesish më specifik. Kjo rezultoi në rritjen e numrit të përgjithshëm të treguesve kryesorë nga 500 në 987. Prandaj, rezultatet e secilit komponent si dhe rezultati final i Indeksit janë ndikuar nga grumbullimi më i detajuar / i veçantë i të dhënave dhe nga komponentët shtesë të përfshirë.

Rezultatet për komponentin statistikor të përfshirë në këtë raport janë të përkohshme, sepse, siç u shpjegua më sipër, vlerësimi i treguesve statistikorë kërkon aplikimin e formulës së transformimit linear për të cilën duhet të mblidhen të dhënat krahasuese nga vendet e tjera të indeksit. Të dhënat e tilla ende nuk janë në dispozicion për shkak të faktit se Kosova, deri më tani, është i vetmi vend ku është testuar struktura e rishikuar e Indeksit. Rezultati i tanishëm i këtij komponenti, për momentin, bazohet kryesisht në rezultatet e mëparshme të Indeksit.

Kjo situatë ndikon edhe në rezultatin final të Indeksit, i cili gjithashtu duhet të konsiderohet i përkohshëm.

Çdo vend pjesëmarrës i ri do të kontribuojë në rishikimin e komponentit statistikor dhe rezultatin përfundimtar të Indeksit.

Shënime përmbyllëse

- ¹ KOMF; Indeksi I Mbrojtjes së Fëmijës
<http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/11/Child-Protection-Index.pdf>
- ² Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve: "Indeksi I mbrojtjes së fëmijës 1.0", seksioni "Cenueshmëria e fëmijës dhe qeverisja", faqets 10-11; <http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/11/Child-Protection-Index.pdf>
- ³ Banka Botërore; <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/MENAEXT/EXTMNAREGTOPGOVERNANCE/0,,contentMDK:20513159~pagePK:34004173~piPK:34003707~theSitePK:497024,00.html>
- ⁴ Mbrojtja e fëmijëve mbulohet nga Komisioni për të Drejtata e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticion (http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,110,133)
- ⁵ <https://data.unicef.org/topic/child-protection/birth-registration/#>
- ⁶ Regjistrimi i lindjeve në Kosovë 2009 UNICEF; https://www.unicef.org/kosovoprogramme/UNICEF_Birth_Registration_2009_English.pdf
- ⁷ Lagji Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, neni 148. Marrja e fëmijëve nga kujdesi i prindërve, neni 149. Privimi nga kujdesi prindëror
- ⁸ Agjencia e Statistikave e Kosovës; Anкета e grupimeve të treguesve të shumëfishtë në Kosovë 2013-2014 <http://ask.rks-gov.net/add-news/shpallen-rezultatet-p%C3%ABrfundimtare-t%C3%AB-anket%C3%ABs-s%C3%AB-grupimeve-t%C3%AB-treguesve-t%C3%AB-shum%C3%AB-fisht%C3%AB-2013-2014/>
- ⁹ Financimi i Shërbimeve Sociale në Kosovë 2017 KOMF, <http://www.komfkosova.org/financimi-i-sherbimeve-sociale-ne-kosove/?lang=en>
- ¹⁰ Rregullorja grk – no.21/2013 mbi protkolin për parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës në institucionet e arsimit para-universitar; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10292>
- ¹¹ <http://ask.rks-gov.net/add-news/shpallen-rezultatet-p%C3%ABrfundimtare-t%C3%AB-anket%C3%ABs-s%C3%AB-grupimeve-t%C3%AB-treguesve-t%C3%AB-shum%C3%AB-fisht%C3%AB-2013-2014/>
- ¹² Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Raporti Vjetor për 2016
- ¹³ Kodi Penal i Kosovës; <http://www.assembly-osova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>
- ¹⁴ Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preventing%20and%20combating%20trafficking%20in%20human%20beings.pdf>; Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,659>; Kodi i Procedurës Penale <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,980>
- ¹⁵ Financimi i Shërbimeve Sociale në Kosovë 2017 KOMF, <http://www.komfkosova.org/financimi-i-sherbimeve-sociale-ne-kosove/?lang=en>
- ¹⁶ Raporti „TIP” i Departamentit të Shtetit për Trafikimin me Njerëz; Tier 2 Kosovo; faqet 231-231; <https://www.state.gov/documents/organization/258876.pdf>
- ¹⁷ Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit; http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AF-TESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf
- ¹⁸ http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L022_en.pdf
- ¹⁹ Ligji për Arsimin Parauniversitar; Neni 5; paragrafi 1.12 dhe 7.4; Neni 40; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preuniversity%20education.pdf>
- ²⁰ Ligji për Familjen; neni 82; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_32_en.pdf
- ²¹ Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF; publikim "Take me home" 2014; faqe 20; paragrafi 4; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/02/Take_me_Home.pdf
- ²² Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare; Neni 7; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf
- ²³ Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, neni 10; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf
- ²⁴ Kodi i Procedurës Penale; neni 297; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf> Kodi i Drejtësisë për të Mitur; neni 71; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-193-eng.pdf>
- ²⁵ Ligji për Familjen; neni 140; paragrafi 5; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_32_en.pdf
- ²⁶ Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF; publikimi „Take me home” 2014; faqe 20; paragrafi 4; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/02/Take_me_Home.pdf
- ²⁷ Ligji për Familjen; nenet 70, 125, 140, 145 dhe 208; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_32_en.pdf
- ²⁸ Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare; neni 11; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2005_02-L17_en.pdf
- ²⁹ KOMF; Analizë e shkurtër buxhetore për politikën e mbrojtjes sociale të fëmijëve në Kosovë; A po arrijnë të fëmijët në nevojë paratë e taksa paguesve? Faqe 16; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/02/Analizane-gjuhen-anlgeze-KOMF_Finale_06.08.2014.pdf
- ³⁰ Ligji për Familjen; Pjesa 5; Seksioni 2; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_32_en.pdf
- ³¹ Ligji për Familjen; Pjesa 5; Seksioni 2; neni 161; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_32_en.pdf
- ³² Ligji për Familjen; Pjesa 2; Seksioni 3; neni 146;
- ³³ Ligji për Familjen; neni 182;
- ³⁴ Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF; publikimi "Take me home" 2014; faqe 11; paragrafi 4; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/02/Take_me_Home.pdf
- ³⁵ Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF; publikimi "Take me home" 2014; faqe 20; paragrafi 4;
- ³⁶ Ligji për Familjen; neni 184;
- ³⁷ MPMS; Udhëzimi Administrativ për rregullimin e procedurës së fëmijëve pa kujdesin prindëror, neni 15.3; <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/SekondarAnglisht/A.1%20No.05-2006%20on%20Establishment%20of%20the%20Panel%20for%20Placing%20Childre.pdf>
- ³⁸ Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit; neni 11; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-164-eng.pdf>
- ³⁹ Raporti i Misionit të OSBE në Kosovë; <http://www.osce.org/mission-in-kosovo/310501>

- ⁴⁰ Ligji për Shëndetin Publik, Kapitulli 15; neni 34; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L78_en.pdf
- ⁴¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës; Kapitulli 23; nenet 273 deri 282; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>
- ⁴² Kodi Penal i Kosovës Nr. 04/I-082, neni 272, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>
- ⁴³ Ligji për Kontrollin e Duhanit; neni 10; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20Tobacco%20Control.pdf>
- ⁴⁴ Strategjia Kombëtare e Kosovës Kundër Drogave dhe Plani i Veprimit; https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Final_Strategy_2012-2017_R.pdf
- ⁴⁵ Ligji për Azil; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20asylum.pdf>
- ⁴⁶ Ligji për Forcat e Sigurisë së Kosovës; neni 13; paragrafi 1; http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L046_en.pdf
- ⁴⁷ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/News/U-perurua-objekti-i-Qendres-se-Azilkerkuesve.aspx>; Raporti i Avokatit të Popullit; shkurt 2017; http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/160-2017_Raport_i_MKPT_p%C3%ABr_Qendr%C3%AB-n_p%C3%ABr_azilk%C3%ABrkues_619394.pdf
- ⁴⁸ Kodi i Drejtësisë për të Mitur; neni 3; paragrafi 5; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-193-eng.pdf>
- ⁴⁹ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 30; http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵⁰ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 29; seksioni 2; http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵¹ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 13; http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵² Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 15; http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵³ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 16; http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵⁴ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 31; seksioni 2; http://www.komfkosova.org/ëp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵⁵ Kodi i Drejtësisë për të Mitur; neni 117; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-193-eng.pdf>
- ⁵⁶ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 20-21; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵⁷ Kodi i Drejtësisë për të Mitur; neni 119; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-193-eng.pdf>
- ⁵⁸ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 31; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf
- ⁵⁹ Kodi i Drejtësisë për të Mitur; neni 3; Seksioni 3; <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-193-eng.pdf>
- ⁶⁰ Të dhëna nga Shërbimi Sprovues i Kosovës për 2016
- ⁶¹ Raporti i monitorimit të KOMF në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan; faqe 17; http://www.komfkosova.org/wp-content/uploads/2016/11/Raporti-i-monitorim-it-te-QKL_KOMF1.pdf



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e
Bashkimit Evropian në Kosovë



Zbatuar nga Koalicioni i OJQ-ve për
Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF

